



*në bashkëpunim me:
in collaboration with*



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

25 PRILL 2021

RAPORT I NDËRMJETËM MONITORIMI - II

26 Mars – 23 Prill 2021

KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA
(KRIIK ALBANIA)
në bashkëpunim me
33 organizata partnere

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

25 PRILL 2021

RAPORT I NDËRMJETËM

MONITORIMI - II

26 mars – 22 prill 2021

Përgatiti: ©  **KRIIK** KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA

Të drejtat e botimit të këtij Dokumenti janë të rezervuara.

Pjesë të këtij materiali **mund të përdoren lirisht**. Në një rast të tillë lutemi citoni burimin.

A: Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019 | Mailing Address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania;

Aksioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 mbështetet financiarisht nga:

- Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar;
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë dhe
- Ministria e Punëve të Jashtme e Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë Raport dhe në çdo publikim tjetër në kuadër të këtij aksioni vëzhgimi, janë përgjegjësi e KRIIK dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar apo opinionin e donatorëve.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. HYRJE	6
II. KONTEKSTI POLITIK DHE INSTITUCIONAL	8
III. AKTE NËNLIGJORE QË RREGULLOJNË APO NDIKOJNË PROCESIN ZGJEDHOR.....	8
IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	10
IV.1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	10
IV.1.1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri)	11
IV.1.2. Komisioni Rregullator (Rregullatori)	13
IV.1.3. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)	14
IV.2. KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR.....	14
IV.2.1. KONSTITUIMI I KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT (KQV).....	15
IV.2.2. KONSTITUIMI I GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE (GNV)	16
V. FUSHATA ZGJEDHORE	17
V.1. MJEDISI I FUSHATËS	17
V.2. PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE PËR PËRFITIM ELEKTORAL.....	24
VI. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE.....	26
VII. MEDIA.....	28
VII.1. MEDIA AUDIOVIZIVE	30
VII.2. MEDIA E SHKRUAR	32
VII.3. MEDIAT ONLINE.....	34
VII.3.1. MEDIAT SOCIALE	34
VIII. ANKESAT DHE APELIMET	35
VIII.1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE.....	35
VIII.2. KOLEGJI ZGJEDHOR.....	39
IX. VËZHGESIT	40
REKOMANDIME	41
MBI KRIK	42
MBI ORGANIZATËN	42
ANGAZHIMI NË LIDHJE ME INTEGRITETIN ZGJEDHOR.....	42
AKRONIME	44

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Zgjedhjet e 25 prillit po mbahen në një situatë tejte të polarizuar dhe konfliktuale si në rrafshin politik ashtu edhe në atë institucional. Blerja e votës, intimidimi i zgjedhësve dhe të tjera krime zgjedhore ishin temë e ditës gjatë fushatës, duke u rritur në intensitet me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Polarizimi i tejskajshëm përshkallëzoi deri në konflikte dhe dhunë fizike mes apo ndaj mbështetësve të disa subjekteve zgjedhore, deri në një humbje jete vetëm katër ditë përpara ditës së zgjedhjeve.
- Mbetet tejte shqetësues efekti që kjo retorikë e ashpër politike dhe incidentet që shoqëruan ditët e fundit të fushatës mund të kenë mbi stepjen e zgjedhësve, veçanërisht të atyre që nuk janë mbështetës të vendosur të asnjërit prej subjekteve zgjedhore.
- Kuadri ligjor për zgjedhjet u plotësua gjatë periudhës së raportimit me akte nënligjore të cilat detajojnë procesin zgjedhor apo e afektojnë atë drejtpërdrejt. KRIIK vlerëson pozitivisht aktin normativ të miratuar nga Komisioni Rregullator, për detajimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhorë, si dhe kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre.
- Institucionet e shëndetit publik janë treguar të ngadaltë dhe pasivë në adresimin e rregullave që duhet të ndiqen lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë. Kufizimet e lëvizjes së shtetasve gjatë natës dhe ndalimi i grumbullimeve mbi dhjetë vetë vazhdojnë të jenë në fuqi dhe mund, potencialisht të përdoren për të kufizuar të drejtat e komisionerëve, vëzhguesve dhe të tjerë aktorëve zgjedhorë gjatë ditës së zgjedhjeve apo numërimit të votave. Autoritetet publike nuk morën asnjë masë për të sqaruar publikisht nëse do të ketë përjashtime nga rregullat përgjatë ditës së votimit apo numërimit të votave për individë të angazhuar në proces.
- Vetëizolimi i detyruar i qytetarëve që vijnë nga Greqia apo Maqedonia përbën një cenim të së drejtës së zgjedhësve për të votuar dhe nuk justifikohet assesi me argumentin e dhënë nga Komiteti Teknik për marrjen e tij.
- Administrimi i procesit zgjedhor është kryer në mënyrë përgjithësisht eficiente përgjatë periudhës së mbuluar në këtë raport, me problematika të cilat gjykohet se nuk e kanë cënuar procesin.
- Vlerësohet se administrimi i aspekteve teknike të procesit zgjedhor nga KQZ-ja ishte më së shumti eficient dhe me transparencë të rritur. Megjithatë, KRIIK vëren se të treja organet drejtuese të KQZ-së, reflektuan sërish një sjellje që nuk është ajo e një institucioni të vetëm, por e tre trupave të ndara funksionalisht nga njëra-tjetra.
- Sjellja e komisionerëve të Rregullatorit dhe KAS-it u evidentua të ishte e ndikuar politikisht, çka u vërejt shpesh në qëndrimet e shprehura nga anëtarët e këtyre komisioneve për çështje në të cilat partitë politike patën qëndrime të ndara.
- Shqetësues mbetet ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve në këtë fazë të procesit zgjedhor. Madje, në disa raste anëtarësia e KZAZ-ve është ndryshuar në pjesën dërmuese të saj, duke angazhuar individë të cilët nuk kanë kaluar në procesin e trajnimit. Vëzhguesit e KRIIK kanë vlerësuar se në disa KZAZ, komisionerët nuk kanë informimit të duhur lidhur me detyrat e tyre.
- Formimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe Grupeve të Numërimit të Votave ka qenë një proces i realizuar në tejkalim të afateve ligjore, për shkak të vonësive të shkaktuara nga partitë politike dhe mos depozitimit prej tyre të propozimeve për anëtarë të këtyre komisioneve.

- Retorika e ashpër, gjuha denigruese ndaj kundërshtarit, akuzat dhe kundërakuzat për blerje vote karakterizuan fushatën në linjë me sjelljen e subjekteve zgjedhore në fushatën e parakohshme të nisur muaj më parë. Krijimi i këtij debati pa përmbajtje, gjatë kësaj fushate elektorale, veçse anashkaloi vëmendjen nga planet dhe programet konkrete të partive politike garuese në këtë proces, të cilat ishin të munguara.
- Me një retorikë të ashpër në fushatën elektorale u përfshi edhe Presidenti i vendit, i cili u angazhua haptas në fushatë kundër maxhorancës aktuale dhe, personalisht, Kryeministrit Rama, duke u pozicionuar si një konkurrent elektoral dhe jo si një figurë mbi palët.
- Policia e Shtetit nuk mbajti asnjë qëndrim dhe nuk ndërmori asnjë masë ndëshkimore ndaj partive politike garuese në zgjedhje për shkeljen e masave kufizuese kundër pandemisë. Ndërkohë, një sjellje totalisht e ndryshme u konstatua ndaj dy kandidatëve të pavarur, të cilët u gjobitën për shkelje të rregullave kundër tubimeve, duke shkelur parimin e barazisë në garë për konkurrentët zgjedhorë.
- Ngritja e të ashtuquajturës Strukturë për Mbrojtjen e Votës nga Partia Demokratike konsiderohet gjithashtu si një fenomen shqetësues. Kjo “strukturë”, e paqartë se nga cili përbëhet dhe si drejtohet konsiderohet një formë parashtetërore dhe aspak e shëndetshme për ligjzbatimin, sjelljen institucionale dhe ndërtimin dhe funksionimin e një shteti ligjor e të së drejtës.
- Retorika e ashpër politike që parapriu dhe ndoqi incidentet e ndodhura dhe mosdistancimi i partive politike nga ushtruesit e veprimeve të dhunshme, përkundrazi duke justifikuar apo mohuar lidhjen me këta individë konsiderohet të jetë tejet problematike.
- Në takimet elektorale të zhvilluara është vërejtur një prani e konsiderueshme e zyrtarëve të lartë të administratës publike, të cilët kanë qenë të shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë lokalë. Përveç faktit që kanë qenë të pranishëm në këto aktivitete elektorale përgjatë orarit zyrtar të punës, një pjesë e tyre kanë qenë të angazhuar në evente edhe si folës dhe protagonist, çka përbën shkelje të kuadrit ligjor zgjedhor apo edhe të statusit të nëpunësit publik.
- Gjithashtu, një shqetësim tjetër i vërejtur është pjesëmarrja e të miturve në eventet elektorale, të shoqëruar nga familjarë si pjesë e audiencës apo duke mbajtur të veshur simbole partiake apo të fushatës.
- Publikimi i raporteve të monitorimit të fushatës zgjedhore nga monitoruesit e KQZ-së ka qenë thuajse inekzistent në përgjithësi dhe totalisht i munguar gjatë fushatës zgjedhore, çka ka sjellë transparencë të reduktuar, mbi një mekanizëm i cili ishte jo eficient qysh në ngjizjen e vet. Mund të konkludohet se mekanizmi i cili synon rritjen e transparencës mbi aktivitetet e fushatës zgjedhore dështoi të arrijë funksionin e vet primar, transparencën në funksion të zgjedhësve, çka është veçanërisht problematike nëse merret në konsideratë se partitë nuk kanë detyrimin ligjor për të raportuar përpara ditës së zgjedhjeve. .
- Evidentohen faqe në Facebook të cilat kanë gjeneruar reklama me pagesë, pavarësisht se nuk janë të afiluara drejtpërdrejt me asnjë forcë politike, çka përbën fushatë nga palë të treta dhe potencialisht, fshehje të shpenzimeve nga subjektet zgjedhore.
- Fushata elektorale, duket se i zbuti disi tonet e aktorëve politike, për sa i përket sulmeve ndaj medias. Megjithatë u evidentuan raste sporadike të përmendjes së medias si një pushtet i kapur nga politika apo edhe raste të sulmeve ndaj gazetarëve apo mediave.
- Autoriteti i Medias Audiovizive nuk përcaktoi afate për kompensimin e minutazhit të munguar që disa media mund të kishin ndaj një subjekti zgjedhor. Mospërcaktimi i një afati të qartë për kompensimin, brenda afatit zyrtar të përfundimit të fushatës elektorale, dhe bartja e këtyre shifrave pas mbarimit të saj, tregojnë për një ngërç në funksionimin e mekanizmit të mbikëqyrjes së mediave.

I. HYRJE

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka ndjekur në vazhdimësi thujtse gjithë proceset institucionale, ligjore e politike që paraprinë Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021, si dhe procesin zgjedhor, që prej shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës.

Opinionet dhe qëndrimet e KRIIK mbi këto zhvillime janë bërë në vazhdimësi publike nëpërmjet Deklaratave apo Qëndrimeve Publike, Letrave të Hapura¹, si dhe nëpërmjet opinioneve dhe sugjerimeve të dërguara ligjvënësve, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, apo edhe takimeve me aktorë politikë e institucionalë.

Përgjatë gjithë këtij aktiviteti të ngjeshur me synim përmirësimin e integritetit të zgjedhjeve në Shqipëri, synimi parësor i KRIIK mbetet fryma kritike dhe konstruktive, evidentimi i pikave të forta dhe i problematikave që kërkojnë përmirësim, si dhe ofrimi i rekomandimeve për përmirësim.

Ky Raport i Dytë i Ndërmjetëm përmbledh vëzhgimin e procesit zgjedhor përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore (prej datës 26 mars deri në datë 23 prill 2021). Raporti duhet të lexohet së bashku me [Raportin e Parë të Ndërmjetëm](#), i cili mbuloi periudhën nga data e shpalljes së zgjedhjeve, deri në datë 25 mars 2021. Raportet e ndërmjetëm të monitorimit u paraprinë nga një [Konferencë për Shtyp](#), e mbajtur në datën 11 Mars 2021, në të cilën KRIIK bëri publike shqetësimet e tij lidhur me katër çështje të rëndësishme të procesit zgjedhor.

Përpos ndjekjes në vazhdimësi të elementëve kontekstualë politikë e institucionalë, vëzhgimi i elementëve teknikë të procesit është fokusuar në sjelljen dhe vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe sjelljen dhe ligjzbatueshmërinë e administratës së KQZ-së; përmbushjen e detyrimeve ligjore prej Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, institucioneve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në procesin zgjedhor apo që luajnë një rol në të; fushatën parazgjedhore të zhvilluar; sjelljen e subjekteve zgjedhore dhe institucioneve, si dhe përdorimin e burimeve shtetërore për përfitim elektoral; etj.

KRIIK ka angazhuar 22 vëzhgues afatgjatë në të gjithë vendin, të cilat janë duke vëzhguar elementë kyç të procesit prej fundit të shkurtit dhe do të vazhdojnë ta ndjekin procesin deri në përfundimin e tij. Gjatë ditës së zgjedhjeve dhe procesit të numërimit të votave. KRIIK do të angazhojë rreth 800 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar aktivitetin e komisioneve zonale të administrimit zgjedhor në të gjitha KZAZ-të e vendit përpara dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe gjatë numërimit të votave; procesin e hapjes, votimit dhe mbylljes së qendrave të votimit në 360 qendra votimi të përzgjedhura në mënyrë rastësore në të gjithë vendin² situatën përreth qendrave të votimit dhe procesin e votimit në rreth 800 qendra votimi, me vëzhgues të lëvizshëm gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe procesin e numërimit të votave.

¹ Përmendet realizimi së fundi i Konferencës Kombëtare “Kostot e Demokracisë II – Paratë në Politikë dhe Integriteti Zgjedhor”, gjatë së cilës u bë publik edhe nisja e Aksionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021.

² Vëzhgimi i 360 qendrave të votimit të përzgjedhura në mënyrë rastësore garanton përgjithësimin e gjetjeve me një marzh gabimi prej ±5%, me një interval besueshmërie prej 95%.

KRIIK e vlerëson procesin zgjedhor duke përdorur si kritere standardet e njohura ndërkombëtarisht për zgjedhje demokratike, si dhe kuadrin ligjor shqiptar.

Aksioni i Vëzhgimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 është duke u realizuar në bashkëpunim me 33 organizata partnere, të cilat operojnë në të gjithë vendin: Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias, Informacionit – Sarandë; E Shkuara për të Ardhmen - Korçë; Epoka e Re – Fier; Forumi Civil Selenicë – Selenicë; Forumi i Gruas Elbasan - Elbasan; Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit – Kuçovë; Gruaja në Zhvillim – Korçë; Grupi Lokal i Veprimit Integrimi - Dibër; Lëvizja Rinore për Demokraci Puke – Pukë; Lëvizja për Zhvillimin e Turizmit - Ksamil; Shoqata Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit – Has; Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK) – Librazhd; Nisma e Luleve - Sarandë; Platforma Kombëtare për Gratë – Fier; Porta Rome për Integrim - Krujë; Shoqata Qëndistaret – Korçë; Unë Gruaja - Pogradec; Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale – Kukës; Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara - Shkodër; Qendra Sociale në Ndihamë të Njerëzve në Nevojë - Fushë Arrëz; Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile - Durrës; Hand to Hand Against Nation Apathy – Lezhë; Qendra Rinore e Vlorës – Vlorë; Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare – Berat; Shoqata Alpin – Tropojë; Shoqata Ekspertët e Rinj Mjedisor – Bulqizë; Shoqata për Gratë dhe Fëmijët – Tiranë; Shoqata Rreze Shprese - Vau Dejës; Sindikata e Pavarur e Tipografëve – Tiranë; The Youth of Ura Vajguore - Ura Vajguore; Together for Roma Integration – Fier; Youth for Social Changes – Vorë dhe Consulting and Development Partners – Shkodër.

KRIIK falënderon të gjithë institucionet, lokale e qendrore, me të cilat ka bashkëpunuar dhe marrë informacion deri në këtë moment; administratën zgjedhore, duke filluar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe të tjerë organizma e bashkëbisedues që kanë asistuar në mbledhjen e informacionit.

KRIIK gjithashtu falënderon mbështetësit financiarë të këtij Aksioni Vëzhgimi, pa mbështetjen e të cilëve nuk do të kishte qenë i mundur një aksion vëzhgimi në një shkallë të tillë.

Aksioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve prej KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021 mbështetet financiarisht nga:

- Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar;
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC);
- Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë dhe
- Ministria e Punëve të Jashtme e Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Opinionet dhe këndvështrimet e shprehura në këtë Raport janë përgjegjësi e KRIIK dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar apo opinionin e donatorëve.

II. KONTEKSTI POLITIK DHE INSTITUCIONAL

Zgjedhjet e 25 prillit po mbahen në një situatë tejte të polarizuar dhe konfliktual si në rrafshin politik ashtu edhe në atë institucional.

Retorikës së ashpër politike dhe akuzave mes subjekteve zgjedhore iu shtua edhe përfshirja e panatyrshme e Presidentit të Republikës në garën elektorale duke mbajtur gjatë gjithë fushatës një qëndrim të qartë kundër maxhorancës qeverisëse e duke e kthyer institucionin e Presidencës, de facto, në një subjekt zgjedhor.

Blerja e votës, intimidimi i zgjedhësve dhe të tjera krime zgjedhore ishin temë e ditës gjatë ditëve që i paraprinë fushatës, por edhe përgjatë fushatës zgjedhore duke shënuar rritje të intensitetit me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Polarizimi i tejskajshëm i klimës u përshkallëzua deri në konflikte dhe dhunë fizike midis apo ndaj mbështetësve të disa subjekteve zgjedhore, duke shënuar madje humbjen e një jetë dhe plagosjen e disa të tjerëve vetëm pak ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Një klimë e tillë ka potencialin dhe duket se po shkakton pasiguri tek zgjedhësit, të përshkallëzuar në disa nivele, nisur nga mungesa e sigurisë për shëndetin publik; mungesa e sigurisë për të dhënat e tyre personale, veçanërisht nën dritën e publikimit të të dhënave personale të rreth 900 mijë qytetarëve të Tiranës; mungesa e sjelljes institucionale, e ligjzbatimit, e mirefunksionimit të institucioneve dhe keqpërdorimit të burimeve shtetërore; mungesa e sjelljes prej shtetari nga zyrtarët më të lartë dhe liderët politikë apo edhe klima e ndezur dhe mundësia për episode dhune gjatë ditës së zgjedhjeve.

Mbetet tejte shqetësues efekti që kjo retorikë e ashpër politike dhe incidentet që shoqëruan ditët e fundit të fushatës mund të kenë mbi stepjen e zgjedhësve, veçanërisht të atyre që nuk janë mbështetës të vendosur të asnjërit prej subjekteve zgjedhore, duke shkaktuar mospjesëmarrjen e tyre në votime.

Nevojitet që Partitë Politike, krerët e tyre dhe gjithashtu institucionet që qëndrojnë mbi palët, duhet të jenë garantë që qytetari të çlirohet nga nxitja e vendimmarrjeve emocionale që vijnë me ashpërsimin e gjuhës, duke bërë thirrje për të ushtruar në mënyrë të lirë e të pandikuar të drejtën e tij të votimit.

III. AKTE NËNLIGJORE QË RREGULLOJNË APO NDIKOJNË PROCESIN ZGJEDHOR

Kuadri ligjor për zgjedhjet është plotësuar gjatë periudhës së raportimit me akte nënligjore të cilat detajojnë procesin zgjedhor apo e afektojnë atë drejtpërdrejt.

Nga tërësia e këtyre akteve vlen të përmendet akti normativ i miratuar nga Komisioni Rregullator, për detajimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, si dhe kontrollin dhe

verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre³. Vendimi u shoqërua me një manual të detajuar për mënyrën e raportimit financiar prej subjekteve zgjedhorë.

KRIIK vlerëson pozitivisht këto dy akte, të cilat mundësojnë dhe përcaktojnë më në detaje rregullat që duhet të ndjekin subjektet zgjedhorë gjatë raportimit mbi veprimtarinë financiare të tyre, si dhe mënyrën se si do të kryhet verifikimi i vërtetësisë së vetëraportimeve pas procesit zgjedhor.

Institucionet e shëndetit publik (Ministria e Shëndetësisë dhe Komiteti Ad Hoc Teknik i Ekspertëve) janë treguar shumë të ngadaltë në adresimin e rregullave që duhet të ndiqen lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, pati dy mbledhje të Komitetit Teknik të Ekspertëve. Në të dy mbledhjet, kufizimet e lëvizjes së shtetasve në fashat orare 22:00 me 06:00 u lanë në fuqi, ndërkohë që në asnjë prej vendimeve të tyre nuk parashikohet krijimi i lehtësive lidhur me lëvizjen e komisionerëve apo vëzhguesve të angazhuar për mbarrëvajtjen e procesit zgjedhor⁴.

Gjithashtu, Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë që kufizon grumbullimet e më tepër se 10 personave duket se do të vijojë të jetë në fuqi ditën e zgjedhjeve dhe në vijim të procesit zgjedhor, si gjatë procesit të votimit, ashtu edhe gjatë atij të numërimit. Mbetet e pamundur objektivisht që ai urdhër të zbatohet⁵, pasi nuk është e mundur që në një qendër votimi të ketë më pak se 10 persona.

Duket se procesi zgjedhor do të zhvillohet në shkelje të detyruar të rregullave të vendosura nga autoritetet për mbrojtjen e shëndetit publik, ndërkohë që këto autoritete nuk morën asnjë masë për të sqaruar publikun apo administratën zgjedhore nëse do të ketë përjashtime nga rregullat përgjatë ditës së votimit apo numërimit të votave.

I vetmi akt i prodhuar nga autoritetet shëndetësore në lidhje me mbajtjen e procesit zgjedhor në kushtet e pandemisë është një protokoll i miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik, i bërë publik në media rreth datës 20 prill (ndërkohë që ai mban datën 13 prill, si datë të miratimit të tij). Protokollin përmban disa udhëzime për mbajtjen e procesit zgjedhor, por në vetvete është jo realist dhe injoron fakte bazike të zhvillimit të procesit zgjedhor⁶.

Në mbledhjen e datës 19 prill 2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve vendosi se të gjithë individët që hyjnë në Shqipëri nga Greqia apo Maqedonia e Veriut do të duhet të vetëizolohen për 14 ditë⁷.

³ Vendim nr. 13 i KQZ-së “[Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore](#)”.

⁴ Duke qenë se komisionerët apo vëzhguesit duhet të jenë në qendrat e votimit për hapjen e tyre në orën 6:00 dhe, me gjasë, procesi i mbylljes së qendrave të votimit dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore nuk ka për të përfunduar në shumë raste përpara orës 22:00, të gjithë individët e angazhuar në administrimin apo vëzhgimin e procesit zgjedhor do të jenë në shkelje të rregullave të vendosura. Mungesa e adresimit publik të çështjes dhe e transparencës nga ana e institucioneve për individët e angazhuar në proces mbetet një problem madhor.

⁵ Është e pamundur që në një Qendër Votimi dhe sidomos në një Vend të Numërimit të Votave, të ketë më pak se 10 persona të grumbulluar në të njëjtin moment.

⁶ P.sh., protokollin vendos disa kërkesa për mjediset në të cilat duhet të vendosen qendrat e votimit, ndërkohë që këto të fundit janë përcaktuar përfundimisht prej datës 15 mars, 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

⁷ [KOMITETI TEKNIK I EKSPERTËVE: RIKTHEHEN NË KLASA SHKOLLAT E MESME, KARANTINË 2-JAVORE PËR PERSONAT QË VIJNË NGA MAQEDONIA E VERIUT DHE GREQIA, 19 PRILL 2021.](#)

Vendimi, sikurse u bë me dije, nuk bazohej në rrezikshmëri të shtuar si pasojë e rritjes së shifrave të infektimeve në këto vende⁸, por në rrezikshmërinë që mund të vijë nga personat që do të hyjnë në vend e që priten të jenë në shifra të larta si rrjedhojë e Pashkëve Ortodokse të 2 majit 2021.

Ky vendim i Komitetit Teknik përbën një cënim të së drejtës së zgjedhësve për të votuar dhe nuk justifikohet me argumentin e dhënë, duke qenë se do të ishte më e arsyeshme që afati i hyrjes në fuqi të vendimit për kufizimin e hyrjeve të mundshme për shkak të Pashkëve të vendosej pas ditës së zgjedhjeve.

Konstatohet shqetësues qasja e evidentuar në prononcimin e bërë nga Kryeministri Rama lidhur me këtë ccështje. I pyetur në një emision televiziv në lidhje me këtë vendim ai sugjeroi se shtetasit shqiptarë që kanë detyrimin të vetizolohen mundet në fakt ta thyejnë detyrimin ditën e zgjedhjeve⁹.

Lëvizja Socialiste për Integrim e ankimoi këtë vendim në Gjykatën Administrative, kjo e fundit shpalli moskompetencën në datë 23 prill, vendim, i cili u ankimua në Gjykatën Administrative të Apelit në të njëjtën ditë.

IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Administrimi i procesit zgjedhor, gjatë kësaj periudhe, ka vijuar punën në dy nivele të tij, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor. Administrimi i procesit zgjedhor është kryer në mënyrë përgjithësisht eficiente përgjatë periudhës së mbuluar në këtë raport, me problematika të cilat gjykohet se nuk e kanë cënuar procesin.

IV.1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet (Komisioneri), Komisioni Rregullator (Rregullatori) dhe Komisioni për Ankimime dhe Sanksione (KAS). Gjatë periudhës zgjedhore, KQZ vijoi administrimin e procesit, ngritjes së infrastrukturës zgjedhore dhe miratimin e akteve normative nënligjore.

Vlerësohet se administrimi i aspekteve teknike të procesit zgjedhor nga KQZ-ja ishte më së shumti eficient dhe me transparencë të rritur.

KRIIK vëren se të treja organet drejtuese të KQZ-së, reflektuan sërish një sjellje që nuk është ajo e një institucioni të vetëm, por e tre trupave të ndara funksionalisht nga njëra-tjetra.

⁸ Si Greqia ashtu dhe Maqedonia e Veriut kanë rënie të vazhdueshme të rasteve të reja të infektuara duke nisur nga data 6 prill. Shih: <https://ourworldindata.org/coronavirus#coronavirus-country-profiles>.

⁹ Kryeministri Edi Rama gjatë një [interviste për emisionin Real Story](#) në 21 Prill 2021, deklaroi në lidhje me qytetarët që vijnë nga këto dy shtete dhe të drejtën e tyre të votimit, duke sugjeruar shkeljen e vendimit “*Kush e ka vërtet me zemër dhe kush vërtet vjen si patriot, meqë paska deklaruar LSI, vjen dhe voton. ... Pra teoria që ne na pengoi karantina dhe u vu karantina për ne është një marrëzi*”.

Sjellja e komisionerëve të Rregullatorit dhe KAS-it u evidentua të ishte e ndikuar politikisht, çka u vërejt shpesh në qëndrimet e shprehura nga anëtarët e këtyre komisioneve për çështje në të cilat partitë politike patën qëndrime të ndara.

Kjo influencë politike arriti në mjaft raste të përballohej nga anëtarët e Rregullatorit, duke bërë që gati të gjitha aktet të miratoheshin në unison prej tyre, përveç rastit të miratimit të fletëve të votimit. Lidhur me këtë çështje, përplasja e fortë e qëndrimeve respektive politike bëri që kjo trupë të hiqte dorë nga përmbushja e detyrimit ligjor që Kodi Zgjedhor i ngarkonte, duke shpallur në mënyrë të papritur moskompetencën për trajtimin e çështjes.

Ndërkohë në KAS kjo influencë vazhdoi të ishte mbizotëruese në gati tërë çështjet e trajtuara, duke shpënë edhe në vendimmarrje të njëanshme politike, jokorrekte e ekstraligjore, veçanërisht të dukshme këto në çështjet e shqyrtuara mbi përdorimin e burimeve shtetërore dhe të miratimit të fletës së votimit.

Në tërësi, kritike evidentohet veprimtaria e KQZ-së përsa i përket menaxhimit të monitorimit të ecurisë së përdorimit të burimeve shtetërore, pavarësisht inefiçencës dhe zhbërjes së tërë mekanizmit të ngritur që erdhi si pasojë e vendimmarrjes së KAS, veprimtarisë së mediave dhe pasqyrit jo-të ekuilibruar prej saj të fushatës së subjekteve zgjedhore, apo edhe monitorimit të ecurisë në tërësi të fushatës zgjedhore, pavarësisht tërheqjes së vëmendjes dhe thirrjeve publike të bëra prej Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

IV.1.1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri)

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvilloi 16 seanca publike, në të cilat u miratuan 101 vendime dhe tri udhëzime.

Në tërësi vendimmarrja ishte rregullisht e publikuar në faqen e internetit të KQZ-së, ku përfshiheshin përveç vendimeve, edhe materialet paraprake të tyre.

Në vazhden e një procesi të filluar me marrjen e detyrës prej tij, Komisioneri vijoi mbajtjen në mënyrë konstante të takimeve konsultative me aktorë të shoqërisë civile, dhe ndjekjen e një qasje institucionale të hapur me aktorë të tjerë, përfshirë ata politikë.

Në tërësi kjo qasje bashkëpunuese vlerësohet se erdhi në ndihmë të përfshirjes në proces të organizatave që punojnë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe medias.

Vlerësohen pozitivisht deklaratat publike të herëpashershme të Komisionerit, nëpërmjet të cilave bëhej transparencë dhe informohej në tërësi opinioni publik mbi ecurinë e procesit, dhe veçanërisht lidhur me thirrjet publike ndaj partive politike dhe jo vetëm, në respektim të ligjit dhe detyrave që kanë aktorët në procesin zgjedhor.

Gjithashtu vlerësohet ecuria dhe puna e administratës së KQZ-së në përballimin e jo pak problematikave të lidhura me një sërë procesesh organizative e tekniko-logjistike për vënien në

funksionim të procesit të identifikimit biometrik të votuesve, monitorimit të qendrave të votimit me kamera, projektit pilot të votim-numërimit elektronik etj.

Një nga vendimet më të rëndësishme të Komisionerit ishte ai mbi përmbajtjen e fletës së votimit, i cili erdhi pas shpalljes së moskompetencës nga ana e Komisionit Rregullator¹⁰. Pavarësisht vonesës në miratimin e këtij vendimi, vlen të theksohet përpjekja dhe konsistenca e sjelljes së Komisionerit për të arritur një konsensus nga partitë politike para miratimit të vendimit¹¹ dhe më pas, vendimmarrja e drejtë prej tij në përputhje të plotë me frymën dhe gërmën e Kushtetutës dhe të Kodit zgjedhor.

Vendimmarrja e Komisionerit ka ndjekur shqyrtimin e denoncimeve të bëra nga subjekte të ndryshme, të cilat kryesisht kishin për objekt shkeljet e evidentuara sipas Vendimin Nr. 9 të Komisionit Rregullator, për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime elektorale. Në tërësi këto vendime nuk konkluduan në sanksione ndaj subjekteve të paditura, dhe vetëm në një rast u vendos sanksion administrativ me gjobë. Në aspektin formal të kësaj vendimmarrje, shqyrtimi i këtyre çështjeve në vazhdimësi u zhvilluan në seanca jo publike.

Një nga risitë e amendimeve ligjore të Kodit Zgjedhor ishte monitorimi i veprimtarisë institucionale. Konstatohet një qëndrim pasiv i administratës dhe Komisionerit për problemet që lidhen me raportimet e institucioneve në ndërfaqen e krijuar enkas për këtë çështje, pasi, ndryshe nga sa përcakton kuadri ligjor, nuk u morën masa për ecurinë e procesit të raportimit. Problematika e vërejtur ka të bëjë jo vetëm me mosraportimin e institucioneve në kohë sipas afateve ligjore dhe të detajuara sikurse parashikohet nga ligji¹², por edhe me raste kur aktivitetet nuk u raportuan fare prej institucioneve respektive.

Kjo situatë ndoqi të njëjtën ecuri, edhe pas evidentimit të nevojës për respektimin e frymës dhe gërmës së Kodit Zgjedhor dhe Vendimit të Komisionit Rregullator, nga dy prej anëtarëve të këtij të Komisioni.

Autoriteti i Medias Audiovizive është i ngarkuar me ligj për monitorimin e sjelljes së mediave gjatë fushatës zgjedhore. Ky monitorim përfshin raportimin e gjetjeve dhe të propozimeve për marrjen e sanksioneve prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë kuadër për këtë fushatë zgjedhore, AMA ka depozituar raportet ditore dhe javore të monitorimit të mediave, dhe ka evidentuar edhe disa raste të shkeljeve të kryera nga disa media.

Përsa mbulon ky raport, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm dy raporte javore të AMA-s, nga të cilat ka konkluduar në tërheqjen e vëmendjes, detyrimin për kompensim të disa mediave dhe sanksionim të disa mediave lokale për mos dorëzim të programeve të regjistruara. Në pjesën tjetër, raportet ditore të monitorimit të medias vetëm janë publikuar në faqen në internet të KQZ-së.

¹⁰ Vendim nr. 12 i Komisionit Rregullator *“Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projekt-vendimit për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”*, 31 mars 2021.

¹¹ Në vendimmarrjen e Komisionerit lidhur me këtë pjesë thelbësisht të rëndësishme të procesit u mor në konsideratë edhe rezultati i një sondazhi të zhvilluar në rrjetet sociale të KQZ-së.

¹² Vendim nr. 9 datë 24.12.2020, *“... Raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë nga data e aktivitetit, datën orën, tematikën e veprimtarisë, të ftuarit më të rëndësishëm, të ftuarit e nderit, folësit.”*

Në rezultante të së tërës, vetëm publikimi periodik i raportimeve ditore pas depozitimit të tyre dhe mosshqyrtimi i tyre në një kohë më të shpejtë, e bëri kuadrin rregullues jo efikas, duke rënë në përsëritje të situatave sikurse në proceset e mëparshme zgjedhore. Periudha e shkurtër kohore e fushatës zgjedhore, mosshqyrtimi me shpejtësi dhe frekuencë më të shpeshtë i raporteve, solli pamundësinë objektive për kompesimin me kohë televizive të subjekteve elektorale të diskriminuara, e rrjedhimisht edhe një fushatë mediatike të njëanshme dhe të pabarabartë midis subjekteve zgjedhore garuese.

IV.1.2. Komisioni Rregullator (Rregullatori)

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Komisioni Rregullator zhvilloi gjashtë seanca publike dhe miratoi tetë vendime. Gjatë periudhës së këtij raporti është evidentuar rritje e tensionit në komunikimin ndërmjet anëtarëve të komisionit, në koherencë kjo me rritjen e polarizimit politik. Njëkohësisht u evidentua qasja e anëtarëve të Rregullatorit në linjë me qëndrimet politike të partive, nga të cilat janë përzgjedhur respektivisht. Pavarësisht sa më sipër, vendimmarrja vijoi të ishte unanime, kjo edhe për shkak të detyrimit ligjor të marrjes së vendimeve me shumicë të cilësuar, pra me të paktën 4 vota pro.

Dy anëtarët e Rregullatorit të propozuar nga opozita parlamentare, shpesh kanë bërë thirrje dhe apel publik duke evidentuar disa problematika. Përgjatë diskutimeve në mbledhjet e KQZ-së, i është bërë thirrje Komisionerit që të reagojë dhe ndërveprojë me institucione të ndryshme në funksion të shqetësimeve të ngritura. Megjithatë, në asnjë nga këto raste, nga Komisioneri nuk pati reagime në ndonjë seancë publike.

Në linjë me sa më sipër konsiderohet edhe shpallja e moskompetencës nga Rregullatori, për projektvendimin për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Vendimmarrje kjo me arsyetimin se Kodi Zgjedhor nuk ia njeh në mënyrë të shprehur kompetencën për miratimin e fletës së votimit, por e lë në diskrecion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Qëndrim ky që vlerësohet se reflektoi mosdakordësinë e fortë politike për këtë çështje.

Ligji i njeh kompetencën Komisionit Rregullator për të miratuar elementet e sigurisë së fletëve të votimit. Përcaktim ligjor sipas të cilit Komisioni Rregullator miratoi vendimin nr. 6 datë 26 shkurt 2021 *“Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”*. Kësioj argumentohet si jo-simetrik që miratimi i detajeve teknike të fletës së votimit të konsiderohet kompetencë e Rregullatorit dhe mos të konsiderohet miratimi i modelit të fletës së votimit.

Miratimi i manualit të KZAZ-ve dhe GNV-ve, ishte një tjetër çështje që u shoqërua me debate gjatë seancës për diskutimin e këtyre projekt-akteve. Kjo për shkak të propozimit të dy draft-akteve nga administrata, ku modeli i dytë, sipas saj, u cilësua si një akt me përmbajtje të njëjtë me të parin, por me vetëm disa ndryshime teknike. E gjithë situata konkludoi me tërheqjen nga Komisioneri të të dy projektakteve të propozuara nga administrata dhe miratimin e tyre në një kohë të mëvonshme.

IV.1.3. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)

Gjatë kësaj periudhe në KAS janë paraqitur dhe shqyrtuar 8 kërkesa ankimore. Për tri prej vendimeve të KAS të ankimuara në Kolegjin Zgjedhor, ky i fundit ka lënë në fuqi vendimin e KAS. Vendimet e tjera të ankimuara janë ende në proces gjyqimi.

Në ndjekje të vendimmarrjes së KAS, evidentohet se ka qenë në pjesën me të madhe miratuar me shumicë të thjeshtë. Vlerësohet si shqetësues që vendimmarrja e KAS shihet si me ndikim të theksuar politik, madje deri në disa raste ekstra ligjore dhe në lundërshtim me frymën e kushtetutës dhe ligjit. Të evidentuara këto veçanërisht lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore dhe miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit me numra.

Unanimiteti në vendimmarrjen e KAS, u evidentua vetëm në rastin kur partitë kryesore politike kanë rezultuar jo të përfshira apo të interesuara për çështjen në diskutim.

IV.2. KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, puna e KZAZ-ve ka qenë kryesisht e përqendruar në formimin e Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe Grupeve të Numërimit të Votave.

Edhe gjatë kësaj periudhe ka vijuar lirimi dhe emërimi i anëtarëve të KZAZ-ve. Në total janë ndërruar së paku 68 anëtarë, sekretarë dhe kryetarë të KZAZ-ve përgjatë periudhës që mbulon ky raport.

Në disa raste, situata paraqitet më shqetësuese, pasi në disa KZAZ anëtarësia e tyre është ndryshuar në pjesën dërrmuese të saj¹³ duke vendosur individë, të cilët nuk kanë trajnimin e duhur. Sipas vëzhguesve të KRIIK, në disa KZAZ është vërejtur mungesë e informimit të duhur të anëtarëve të komisionit lidhur me detyrat e tyre.

Ecuria e formimit të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe Grupeve të Numërimit të Votave ka qenë një proces i realizuar në tejkalim të afateve ligjore, për shkak të vonësive të shkaktuara nga partitë politike dhe mos depozitimit prej tyre të propozimeve për anëtarë të këtyre komisioneve.

Evidentohet ende shqetësues dypunësimi i anëtarëve të KZAZ-ve¹⁴ të cilët njëkohësisht janë punonjës edhe të administratës publike dhe që nuk kanë pezulluar përkohësisht punësimin e tyre. Kjo ka sjellë pamundësinë e mbledhjes së komisioneve sidomos gjatë paradites apo përpara orarit zyrtar të punës, duke shkaktuar vështirësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore prej KZAZ-së.

Gjithashtu, në vazhdimësi dhe me intensitet më të shtuar është evidentuar një pjesëmarrje shumë aktive e anëtarëve të KZAZ-ve në fushatat elektorale të partive respektive. Pavarësisht se ligji nuk e ndalon në gërmën e tij, angazhimi aktiv dhe i shpeshtë i zyrtarëve zgjedhorë në fushatën zgjedhore,

¹³ KZAZ nr. 26, nr. 27, nr. 36, nr. 11, nr. 83, nr. 84.

¹⁴ KZAZ 18 Bulqizë.

përpos se cënon kohën në dispozicion të angazhimit si komisioner i KZAZ-së, forcon dhe nxit më tej partizanizmin politik në përmbushjen e detyrave ligjore si anëtar i KZAZ-së.

IV.2.1. Konstituimi i Komisioneve të Qendrave të votimit (KQV)

Anëtarët e KQV-ve propozohen nga partitë politike dhe emërohen me vendim nga Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve. Sa i përket përbërjes së KQV-ve, ajo reflekton të njëjtën përkatësi politike si KZAZ-ja.

Duke qenë se Partia Socialdemokrate nuk propozoi anëtarë për 56 KZAZ¹⁵, edhe komisionet e qendrave të votimit reflektojnë përbërje me anëtar të propozuar nga PS për të zëvendësuar mungesën e propozimeve të PSD. Ky organizim i përkatësisë partiake të një anëtari është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor.

Afatet ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor lidhur me propozimin dhe emërimin e anëtarëve të KQV-ve janë përkatësisht datat 26 mars dhe 5 prill 2021. Ky afat rezultoi i papërmbushur nga një pjesë e konsiderueshme e KZAZ-ve dhe nga të gjitha partitë politike që ligji iu jep të drejtën për të propozuar komisionerët e qendrave të votimit.

Përpos mos respektimit të afatit prej partive politike edhe ndryshimet shumë të shpeshta të anëtarëve të KQV-ve të propozuara vështirësuan ecurinë përgatitore në këtë nivel të administrimit. Konstatohet se deri një ditë më parë nga data e publikimit të këtij raporti, ende rezultojnë komisione të qendrave të votimit të paformuara.

Deri në datën e këtij raporti nga vëzhguesit afatgjatë është raportuar se nuk janë formuar Komisionet e Qendrave të Votimit në tri¹⁶ KZAZ, ndërsa në dy¹⁷ KZAZ ato janë formuar pjesërisht. Ky informacion është mbledhur nëpërmjet bisedave të vëzhguesve të KRIIK me anëtarët e KZAZ-ve, pasi këta të fundit nuk pranonin të vinin në dispozicion të vëzhguesve kopjet përkatëse të vendimeve të KZAZ-së. Kjo situatë në disa raste është shkaktuar për shkak të mosnjohjes së kuadrit ligjor prej anëtarëve të KZAZ-ve¹⁸ dhe në disa të tjera është argumentuar si pasojë e intensitetit të lartë të punës së këtyre ditëve.

Asnjë subjekt zgjedhor nuk e respektoi afatin e dorëzimit të propozimeve për anëtarë të KQV-ve¹⁹. Gjithashtu, sërish evidentohet, sikurse edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, ndërrimi i anëtarëve²⁰ të propozuar dhe emëruar në KQV.

¹⁵ Shih [Raportin e Parë të Ndërmjetëm](#) të KRIIK për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit 2021.

¹⁶ KZAZ 21, Durrës si pasojë e mosnjohjes së propozimeve për anëtarë të KQV-ve nga ana e PS, PD dhe LSI.

PD nuk i ka sjellë propozimet për anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit në KZAZ 24, Durrës.

PSD nuk i ka sjellë propozimet për anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit në KZAZ 81 Libohovë.

¹⁷ KZAZ 76 Përmet, KZAZ 78 Memaliaj.

¹⁸ KZAZ nr. 5 Bashkia Shkodër, KZAZ nr. 1 Bashkia Malësi e Madhe, KZAZ nr. 28 Bashkia Kamëz.

¹⁹ PS nuk ka dërguar brenda afateve të përcaktuara nga Kodi propozimet për anëtarët e KQV në KZAZ nr. 10 në Has, KZAZ nr. 11 në Kukës, KZAZ nr. 13 në Lezhë, KZAZ nr. 25 në Shijak, KZAZ nr. 61 në Roskovec, KZAZ nr. 65 në Berat, KZAZ nr. 78 në Memaliaj.

Madje disa anëtarë të KZAZ-së kanë pohuar se një fenomen i tillë, nisur edhe nga praktikat e mëparshme, ndodh deri në 24 orë përpara datës së zgjedhjeve, ndaj ata përpiqen të gjejnë forma jokorrekte për të respektuar formalisht afatin ligjor të parashikuar për ngritjen e tyre²¹.

Një problematikë shqetësuese evidentohet ndryshimi i adresave të Qendrave të Votimit, pas hartimit të listës finalë të listës së zgjedhësve. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.

Gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja ka vendosur ndryshimin e adresës për 106 qendra votimi, kryesisht për shkak të sipërfaqes së vogël të QV-së, dëmtimeve nga tërmeti, mosrealizimit në kohë të rikonstruksionit të objektit, apo amortizimit të ambienteve duke mos plotësuar kriteret e duhura për të shërbyer si një qendër votimi.

Vëzhguesit kanë raportuar në disa bashki²² problematikën e ekzistencës së qendrave të votimit që nuk përmbushin kriteret apo standardet për të qenë të tilla.

Situata e krijuar është pasojë e mospërmbushjes së detyrimit ligjor të parashikuar nga ana e kryetarëve të bashkive, të cilët nuk kanë kryer në mënyrën e duhur procesin e verifikimit, kontrollit dhe më pas të propozimit të ambienteve të përshtashme për qendra votimi.

Gjithashtu, evidentohet se edhe në këtë proces zgjedhor pjesëmarrja në trajnime e anëtarëve të KQV-ve rezulton të jetë e ulët, duke ngritur pikëpyetje për procesin e administrimit në qendrat e votimit dhe veçanërisht në raport me elementët e rinj të procesit si identifikimi biometrik i zgjedhësve, vëzhgimi me kamera i QV-ve dhe situata e pandemisë.

IV.2.2. Konstituimi i Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)

Grupet e Numërimit të Votave (GNV) formohen me përkatësi sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor²³ në nenin 95 të tij.

Ndërsa PD nuk ka dërguar brenda afateve propozimet për anëtarët e KQV-ve në KZAZ nr. 10 në Has, nr. 11 në Kukës, KZAZ nr. 13 në Lezhë, KZAZ nr. 17 në Klos, KZAZ nr. 25 në Shijak, KZAZ nr. 78 në Memaliaj.

LSI nuk ka dërguar brenda afateve propozimet për anëtarët e KQV-ve në KZAZ nr. 10 në Has, KZAZ nr. 11 në Kukës, KZAZ nr. 13 në Lezhë, KZAZ nr. 15 në Kurbin, KZAZ nr. 25 në Shijak, KZAZ nr. 78 në Memaliaj.

PSD nuk ka dërguar brenda afateve propozimet për anëtarët e KQV-ve në KZAZ-të nr. 10, 11, 13, 14, 15, 25, 26, 32, 39, 4, 5, 73 dhe 82.

²⁰ KZAZ 17, Klos, KZAZ 26 Vorë, KZAZ 75 Kolonjë, KZAZ 79 Tepelenë, KZAZ 87 Selenicë, KZAZ 62 Mallakastër.

²¹ Anëtarët e KZAZ-ve janë të ndërgjegjshëm lidhur me këtë fenomen, madje në KZAZ nr. 58 në bashkinë Fier, vendimit të emërimit të tyre i është vendosur data dhe firmat përkatëse, por jo emrat e anëtarëve të KQV-ve për t'i vendosur ato në momentin final të emërimit të tyre. Kjo sjellje në përpjekje për respektimin e ligjit në pikëpamje të afatit, por të shkeljes së tij në pikëpamje të firmsojes së një akti pa përmbajtje.

Ndërkohë, KZAZ-ja nr. 56 në Divjakë dhe KZAZ-ja nr. 60 në Patos kanë vendosur me marrëveshje moszbardhjen e vendimeve deri në marrjen e kandidaturave finale prej partive politike.

²² Bashkia Përmet, Bashkia Mallakastër, Bashkia Shkodër, Bashkia Kamëz, Bashkia Tiranë.

Komisioneri me vendimin nr. 193 datë 31 mars 2021 caktoi partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë²⁴ të GNV-ve. Sipas këtij vendimi, partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, si parti e koalicionit zgjedhor PD-AN nuk legjitimohej të propozojë anëtarin e katërt të GNV-ve, për arsye se të drejtat e saj si subjekt janë përmbushur nga partia udhëheqëse e koalicionit PD-AN (Partia Demokratike). PDIU e ankimoi këtë vendim në KAS dhe Kolegjin Zgjedhor, të cilat lanë në fuqi vendimin e Komisionerit. Në përfundim, anëtarët e GNV-ve do të jene dy të propozuar nga Partia Socialiste, një nga Partia Demokratike dhe një nga Lëvizja Socialiste për Integrim.

Numri i GNV-ve që do të numërojnë votat në rang Zone Administrimi Zgjedhor, caktohet me vendim nga KZAZ-ja. Kriteret teknike për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit të Votave për çdo Vend të Numërimit të Votave, dhe rregullat për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit u specifikuan dhe përcaktuan me vendim nga Komisioni Rregullator.

Gjithashtu, edhe manuali i punës së GNV-ve u miratua në mbledhjen publike të Komisionit Rregullator të datës 20 prill 2021.

Edhe pse Kodi Zgjedhor përcakton afatin prej 10 ditësh përpara ditës së zgjedhjeve për Ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) janë raportuar mjaft raste ku këto të fundit ende nuk janë formuar²⁵, ndërsa në disa KZAZ ato janë formuar pjesërisht²⁶. Ndërkohë në disa KZAZ konstituimi²⁷ i GNV-ve u krye përtej afatit ligjor²⁸.

V. FUSHATA ZGJEDHORE

V.1. MJEDISI I FUSHATËS

Fushata zgjedhore u karakterizua nga një klimë tejet e polarizuar, e cila u përshkallëzua me afrimin e ditës së zgjedhjeve me incidente në ditët e fundit të saj, të cilat rezultuan në një humbje jete dhe disa të plagosur, përfshi një efektiv të policisë së shtetit.

²³ [Kodi Zgjedhor](#), Neni 95 “Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave”.

²⁴ [Vendim nr. 193 datë 31 mars 2021](#) “Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Socialiste e Shqipërisë. Partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim”.

²⁵ KZAZ nr. 21, 22 në Durrës PS dhe PD nuk kanë dërguar propozimet për anëtarë të grupeve të numërimit të votave. KZAZ nr. 68 në Skrapar nuk janë formuar grupet e numërimit të votave.

KZAZ nr. 21, 22 e 24 në Durrës dhe nr. 82 në Dropull, PD dhe LSI nuk ka dërguar propozimet për anëtarë të grupeve të numërimit të votave.

²⁶ KZAZ 33, 39, 40 Tiranë, KZAZ 90 Sarandë.

²⁷ KZAZ 60 Patos, KZAZ 66 Berat, KZAZ 67 Poliçan, KZAZ 81 Libohovë.

²⁸ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 95, pika 1 “Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave”.

Retorika e ashpër, gjuha denigruese ndaj kundërshtarit, akuzat dhe kundërakuzat për blerje vote karakterizuan fushatën²⁹ në linjë me sjelljen e subjekteve zgjedhore në fushatën e parakohshme të nisur muaj më parë.

Krijimi i këtij debati pa përmbajtje, gjatë kësaj fushate elektorale, veçse anashkaloi vëmendjen nga planet dhe programet konkrete të partive politike garuese në këtë proces.

Me një retorikë të ashpër në fushatën elektorale u përfshi edhe presidenti i vendit Ilir Meta, i cili u angazhua haptas në fushatë kundër maxhorancës aktuale dhe, personalisht, Kryeministrit Rama, duke u pozicionuar si një konkurrent elektoral dhe jo si një figurë mbi palët³⁰.

Në kushtet e pandemisë, organizimet e tubimeve dhe grumbullimeve në ambiente të hapura dhe të mbyllura, u ndaluan sipas një urdhri të Ministrisë së Shëndetësisë, vendim i cili solli edhe një rikonceptim të organizimit të fushatës elektorale³¹.

Fushata nisi me takime derë më derë, evente virtuale dhe, fillimisht, mitingjet masive shin të kufizuara. Megjithatë, me afrimin e ditës së zgjedhjeve eventet masive u shtuan, në shkelje të hapur të masave kufizuese³², madje edhe në mjedise të mbyllura³³.

Shkelja e masave kufizuese ishte dhe një nga argumentet e përdorura për fushatë elektorale nga maxhoranca në nisje të fushatës, duke e akuzuar opozitën se po tregojë e papërgjegjshme dhe po shtonte rastet e infeksioneve³⁴.

²⁹ Me tona më të ashpra ka qenë retorika e kreut të qeverisë Rama, të cilat në daljet e tij publike, në mënyrë të përsëritur, vijoi etiketimet për kundërshtarët, ashtu siç ishte vërejtur edhe në periudhën parazgjedhore. Kreu i opozitës Lulzim Basha, u tregua më i reformuar në gjuhën e tij, duke shmangur etiketimet personale.

³⁰ Ilir Meta në një deklaratë për mediat në Vlorë 10 prill 2021 “... Kryeministri në detyrë ka një kartelë të psikiatrisë, që nga koha e komunizmit, të cilën ua kam thënë para disa ditësh dhe do ua them në Vlorë, më 25 prill në Vlorë, ku shqiptarët të tregojnë ai do të tregojë kartelën...”

³¹ Ndalimi i grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura

³² Ndërsa Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim u përpoqën të respektonin distancat e nevojshme mes pjesëmarrësve, nëpërmjet një skenografie të veçantë, eventet e Partisë Demokratike u organizuan në format më tradicional dhe nuk respektuan asnjë standard dhe kufizim për parandalimin e përhapjes së Covid-19 (p.sh. [Mitingu elektoral në Durrës & Malësi të Madhe! Basha pritet me entuziazëm nga qytetarët, thirrjet e tyre: O hero, Shqipëria ty të do](#)). që mund të kishin pasoja deri në humbje jete për shkak të virusit. Mosruajtje e masave anticovid janë vënë re nga subjekti politik PD në takimet e zhvilluara në Pogradec, Korçë, Elbasan, Klos, Mat, Bulqizë, Dibër, si dhe subjekti politik LSI në Lezhë dhe Fier.

³³ Në bashkinë Dibër takimi elektoral i FRD-së është zhvilluar në një ambient të mbyllur me një pjesëmarrje prej më shumë se 200 vetësh pa respektuar masat anticovid. Në bashkinë Tiranë, subjekti politik PS ka zhvilluar takim në një mjedis të mbyllur me prani të më shumë se 15 persona. Në bashkinë Elbasan po ky subjekt ka zhvilluar takim në një mjedis të më shumë se 70 personave dhe në bashkinë Fier me një pjesëmarrje të 35 personave. Gjithashtu në qytetin e Fierit në takimet e subjekteve politike si LSI dhe PD është vënë re pjesëmarrje mbi 10 persona në mjedise të mbyllura.

³⁴ Reagimi i Kryeministrit Rama në Twitter 30 Mars 2020

“O lula unë jam i frikësuar për njerëzit tuaj që i bëni mish për top me grumbullimet e turpshme të papërgjegjshmërisë suaj, duke mbledhur njerëz të verbër me makina e me bori, që virusi të bëjë dasmë teksa dhëndri juaj premton ta bëjë ditën natë! Premtim i mbajtur fatkeqësisht!”

Policia e Shtetit nuk mbajti asnjë qëndrim dhe nuk ndërmori asnjë masë ndëshkimore ndaj partive politike garuese në zgjedhje për shkeljen e masave kufizuese. Ndërkohë, një sjellje totalisht e ndryshme u konstatua ndaj dy kandidatëve të pavarur, të cilët u gjobitën për shkelje të Urdhrit të Ministrisë për tubimet³⁵, duke shkelur parimin e barazisë në garë për konkurrentët zgjedhorë³⁶.

Fushata zgjedhore u karakterizua nga një mungesë platformash elektorale të shkruara nga partitë politike kryesore, me prioritete të shprehura në evente publike e intervista në media, por në mungesë të dokumenteve konkrete në formën e një programi³⁷.

Ndërkohë, disa prej subjekteve të tjera zgjedhore publikuan programe më konkrete³⁸. Analizimi i këtyre programeve në hapësirat mediatike, nga vetë partitë dhe ekspertë të fushave përkatëse, mungoi. Qytetari nuk u njoh në mënyrë shteruese për specifikat e programeve apo planeve të veprimit, duke shkuar drejt ditës së votimit jo plotësisht i informuar mbi një ndër elementet kryesore që duhet të orientojë votën³⁹.

Temat kryesore të fushatës zgjedhore ishin punësimi, kriza ekonomike, reforma në drejtësi, investimet e huaja në vend, largimi i qytetarëve nga Shqipëria menaxhimi i pandemisë, fushata e vaksinimit, si dhe procesi i rindërtimit pas tërmetit të 26 nëntorit 2020.

Në mënyrë të përsëritur Kryeministri do të bënte krahasime nëpërmjet [fotomontazheve](#) të organizimeve të Partisë Socialiste dhe asaj Demokratike, duke e nxjerrë në pah sipas tij, diferencën e madhe që ekzistojnë mes këtyre forcave, kur bëhet fjalë në menaxhimin e pandemisë.

³⁵ Në datë 12 Prill 2021, Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjes Administrative, vendosi të ndëshkojë Iljaz Shehun, kandidatin në këtë qark i Lëvizjes Vetëvendosjes me shumën 5 milionë lekë për shkeljen e urdhrit të Ministrisë për grumbullimin e më shumë se 10 personave në ambientet e hapura.

Në datë 26.03.2021 Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjes Administrative, vendosi të ndëshkojë Elton Debreshin, kandidatin e pavarur në qarkun e Dibrës me shumën 5 milionë lekë për shkeljen e urdhrit të Ministrisë për grumbullimin e më shumë se 10 personave në ambientet e hapura.

³⁶ Madje zbatimi i njëanshëm i ligjit është nxitur edhe prej kryeministrit në deklaratimet e tij publike. P.sh., Kryeministri Rama, [gjatë një interviste në Opinion TV Klan](#) në 25 mars 2021 duke komentuar, aktivitetin e hapjes së fushatës së PD, “Unë nuk e di çdo bëjë policia në këtë rast, pasi unë nuk i kam thënë gjobit apo mos gjobit... por unë shpresoj që në këtë rast policia mos bëjë gjë, pasi ata janë artistë të bëjnë viktimitë. Sepse më pas policia do të hajë të gjithë baltën që prodhohet në klubet mediatike të natës.

³⁷ - Partia Socialiste deklaroi se nuk kishte një program elektorale, por se ideja e saj për qeverisje në katër vitet e ardhshme bazohej në një plan veprimi, i cili nuk është i publikuar në asnjë faqe zyrtare të kësaj partie (shih: [intervistën e Kryeministrit Rama në 2 Prill 2021](#): “...Ne nuk kemi një program... Ne kemi plan-veprimi 2021-2025....Dhe është i qartë, për shembull, ne nuk themi do ulim taksën se e kemi bërë zero dhe ajo që themi është se këto do rrinë zero. Plani i veprimit është program për kudo në të gjithë sektorët”

- Në faqen online shqipëriafiton.al Partia Demokratike ka të publikuar “[PREZANTIMETPROGRAMI SHQIPËRIA FITON](#)”, në të cilat paraqiten shtyllat kryesore, me hapat që do të ndërmerren në sektorë të ndryshëm të shoqërisë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, nëse zgjidhet si koalicion fitues në zgjedhjet e përgjithshme.

- Lëvizja Socialiste për Integrim ka të publikuar në faqen e saj zyrtare në një kopje elektronike dhe nëpërmjet disa videoeve ilustruese programin e saj të quajtur “[Prioritet zgjedhore 2021](#)”.

³⁸ Ndërkohë, që në faqet e tyre zyrtare janë të publikuara edhe programet e partive Lëvizja për Ndryshim, Bindja Demokratike dhe Nisma Thurje

Maxhoranca nuk i ofroi qytetarëve një bilanc të tetë viteve qeverisje, por zhvilloi një fushatë që fliste mbi investimet që do të kryheshin në vend në katër vitet e ardhshme⁴⁰.

Ndërkohë, në fushatë munguan debatet mes kandidatëve të subjekteve zgjedhore, me përjashtime të vogla në evente të organizuara nga organizata të shoqërisë civile në disa bashki të vendit.

Disa gazetarë përgjatë transmetimeve të tyre lanë të kuptohet se ky ishte një vendim që vinte nga brenda partive politike. Por edhe pse publikisht Kryeministri Rama nuk pranoi të kishte një vendim të tillë, brenda Partisë Socialiste, deklarata sporadike nga përfaqësues të saj lanë të kuptojnë se ky ishte një vendim i marrë brenda partisë⁴¹. Kreu i opozitës, Basha, në mënyrë të përsëritur i kërkoi Kryeministrit Rama përballje në një debat publik. Ftesë e cila u refuzua disa herë nëpërmjet batutave nga ky i fundit⁴².

Mediat dhe partitë politike, sidomos ato opozitare dorëzuan në organin e Prokurorisë së Posaçme SPAK, një sërë denoncimesh për përpjekje për blerje votash, në këmbim të parave apo të të mirave materiale⁴³, ndërkohë që një numër i konsiderueshëm rastesh u bënë publike në media.

Në SPAK u dorëzuan 91 kallëzime për të cilat është filluar procedim penal nga policia gjyqësore nën drejtimin e prokurorëve të posaçëm⁴⁴.

Çështja e intimidimit të votuesve dhe blerja e votës ishte një ndër debatet kryesore në këtë fushatë elektorale. Deklarimet e aktorëve kryesorë politikë, por edhe raportimet në media krijuan një klimë tensioni tek qytetarët, edhe përpara fillimit të fushatës.

Një fakt tjetër shqetësues, përgjatë kësaj fushate elektorale ishin edhe deklarimet e Kryeministrit Rama për ndërprerjen e vaksinimit, nëse opozita do të vinte në pushtet⁴⁵.

⁴⁰ [Edi Rama në takim me banorët në Bylis 3 prill 2021](#) “...Ne kërkojmë mandatin e tretë, por nuk vijmë nga dy mandate. Vijmë nga një mandat dhe një luftë që nuk ka përfunduar. Kjo luftë do të kishte gjunjëzuar shumëkënd, por jo qeverinë tonë. Një tërmet shkatërrimtar dhe një tjetër tërmet tronditës për të gjithë botën...”

⁴¹ Damian Gjijnuri, në një takim me banorët e Vlorës, diskutoi ftesën që Presidenti Meta i bëri për një debat publik “Unë jam këtu për popullin. Nëse presidenti deklarohet se ai është lideri i qarkut të opozitës, unë madje do të shkel edhe rregullin e vendosur nga partia dhe përballem, sepse ne kemi prioritet të takohemi me njerëzit”.

⁴² Kryeministri Edi Rama deklaroi se ishte i dyzuar rreth këtij vendimi, pasi ai nuk kuptonte realisht, kush ishte kreu i vërtetë i opozitës, edhe pas ftesës publike që mori nga Presidenti Ilir Meta, për një përballje mediatike me të.

⁴³ [Raportim i TPZ.al në datë 14 Prill 2021](#), LSI Vlorë, akuzoi përfaqësues të administratës të PS, për blerje vote dhe mbledhje të kartave të identitetit të qytetarëve në Shkallnur, Romanat, Maskuri, Bozanxhi, dhe Arapaj

[Njoftim i Drejtorisë së Policisë në datë 10 Prill 2021](#) “Pukë – Hartonin lista me të dhënat e kartave të identitetit, duke iu premtuar qytetarëve lekë në këmbim të votës, vihet në pranga sekseri”.

[Deklaratë e Policisë në Qarkun e Dibres: Arrestohen në flagrancë 2 shtetas, për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim dhe “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore.](#)

⁴⁴ [Të dhënat statistikore të Prokurorisë së Posaçme, deri me datë 22.04.2021](#) ”

- Subjekte politike 55 raste, kallëzime (PD – 50; LSI – 3; PS – 1; FRD – 1)
- Policia gjyqësore 10 raste, referime.
- Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore 4 raste, procedime penale
- Shtetas 4 raste, kallëzime.
- Institucioni i Presidentit të Republikës 18 raste, informacione

Përfshirja e një procesi kaq të rëndësishëm i cili ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin e jetës së qytetarëve, në debate të tilla politike, për qëllime orientimi vote apo edhe intimidimi, nuk i shërbejnë aspak një procesi zgjedhor normal, madje ndikojnë negativisht në perceptimin e qytetarëve mbi sigurinë e jetës dhe të së ardhmes së tyre, veçanërisht kur deklarime të tilla bëhen nga zyrtarë të lartë të shtetit.

Deklarata me natyrë kërcënuese për një votë të drejtuar Kryeministri Rama i shprehu edhe në deklaratën e tij për infermieret dhe mësuesit, gjatë një komunikimi live në faqen zyrtare të tij në Facebook⁴⁶.

Ngritja e të ashtuquajturës Strukturë për Mbrojtjen e Votës nga Partia Demokratike konsiderohet gjithashtu si një fenomen shqetësues. Kjo “strukturë”, e paqartë se nga cili përbëhet dhe si drejtohet, ishte përgjegjëse për disa ndalime të individëve, të akuzuar nga PD-ja se ishin angazhuar në veprimtari të paligjshme për blerjen e votave, përfshi incidentin që solli një humbje jete dhe disa të plagosur në Elbasan në 21 prill. Një qasje e tillë konsiderohet një formë parashitetore dhe aspak e shëndetshme për ligjzbatimin, sjelljen institucionale dhe ndërtimin dhe funksionimin e një shteti ligjor e të së drejtës.

Publikimi i një baze të dhënash e cila, sipas medias që e publikoi, përmbante të dhëna nga sistemi i patronazhimit të ngritur nga Partia Socialiste dhe kishte rrjedhur nga zyrat e kësaj partie, shkaktoi një debat të gjerë në opinionin publik⁴⁷. Ekspozitë të lartë socialistë patën qëndrime kontradiktore në lidhje me këtë bazë të dhënash, fillimisht duke e relativizuar ekzistencën e saj dhe më pas duke mohuar që ajo të ishte një bazë të dhënash e PS-së, ndërkohë që vazhduan të mbronin strukturën e patronazhimit⁴⁸ dhe konsideruar atë si një fenomen normal.

⁴⁵ Edi Rama në një takim me banorët e Shkodrës 31 Mars 2021 “... Po të vijnë këta (PD) do vazhdojë vaksinimi? Harrojeni! Këta nuk dinë. Më tregoni një qendër shëndetësore? Nuk dinë. Është mbledhur paaftësia dhe indiferenca. Ata dinë vetëm 2 gishta dhe Rama ik...”

⁴⁶ Kryeministri Edi Rama [një komunikim live](#) me përfaqësues të Partisë Socialiste, në lidhje me punësimet në administratë deklaroi në 6 Prill 2021 “Tani mësuesit dhe infermierët kanë hyrë me meritë, por duhet ta mbrojnë se me votën në drejtim të paditur ikën në drejtim të paditur”.

⁴⁷ Sipas lapsi.al, kjo databazë, burimi i të cilës u mbajt i fshehtë, menaxhohej nga ata të quajtur “patronazhistë”, persona të cilët ishin të ngarkuar tëurvejonin preferencat politike të qytetarëve të Tiranës. Elementi kryesor, i këtij publikimi, për të cilën SPAK nisi hetimet, ishin burimi i këtyre të dhënave, të paraqitura në këtë databazë, të cilat duhen të jenë konfidenciale dhe të mbrojtura nga shteti. Partia Socialiste u akuzua, se burimin e këtyre të dhënave e kishte marrë pikërisht nga E-Albania, ndërsa dëshmi të qytetarëve të cilat figuronin në këto lista siguronin se këto të dhëna mund të kishin dalë vetëm prej kësaj platforme dixhitale. Sipas portalit Lapsi.al, patronazhistët, në dijeni edhe të të dhënave tejet personale të qytetarëve, i përdornin për të intimiduar ata për të drejtuar votën drejt partisë socialiste, apo kërcënimeve që të mos shkonin të votonin, nëse vota nuk të ishte për partinë në pushtet.

([Raportim i lapsi.al “Zbërthehet burimi i Lapsi.al/Si e përdorin Drejtuesit Politikë të PS programin me të dhënat për 3.5 milion shqiptarë”](#)).

⁴⁸ Kreu i Partisë Socialiste, e mohoi në daljet e tij publike se ajo databazë e tij formati të publikuar të ishte e Partisë Socialiste, por ai nuk u distancua aspak nga ekzistenca e një databazë të tillë, që përdorej në PS. Madje termi “patronazhist” u be pjesë e retorikës së tij politike dhe batutatave të fjalimeve të tij, duke i dalë në krah këtyre personave, pjesë e strukturave të kësaj partie. Edi Rama në një takim me banorët në Tiranë 18 Prill 2021 “Le të thonë

Të dhënat e përmbajtura në bazën e të dhënave, nga shumë elementë duken të jenë të dhëna që kanë dalë nga një institucion shtetëror që ka akses, çka përbën abuzim me funksionin shtetëror si dhe shkelje flagrante e ligjit dhe të sigurisë së të dhënave të shtetasve. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), agjencia shtetërore që administron sistemin e-Albania, nga ku supozohet se kanë dalë të dhënat në këtë bazë të dhënash mohoi akuzat që të dhënat të kishin dalë nga kjo platformë⁴⁹.

Konstatohet tepër shqetësues minimizmi i problematikës dhe adresimi i saj prej funksionarëve të lartë shtetërore dhe eksponentëve të maxhorancës thjesht në pikëpamje të mbrojtjes së imazhit partiak, dhe aspak me një qasje prej shtetari, përgjegjës për të siguruar zbatimin e ligjit, ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të mëtejshëm të këtyre të dhënave, dhe më pas të hetimit dhe nxjerrjes së përgjegjësi përkatesë institucionale.

Tensionimi i retorikës politike, më afrimin e datës së zgjedhjeve u përthye edhe në tensionim të situatës në terren.

Në media u raportuan incidente të cilat kishin të përfshirë përfaqësues të partive politike nëpër rrethe, duke krijuar kështu një klimë të tensionuar si dhe konflikte të karakterit elektorale⁵⁰. Ngjarja e ndodhur në Kavajë, që rezultoi me plagosjen e sekretarit të PD në zyrat elektorale të këtij qytetari, iu atashua menjëherë qëllimeve politike⁵¹. Reagimi i ashpër i kreut të PD-së Lulzim Basha, me shkuarjen e tij në vendin e ngjarjes si dhe konsiderimin e saj si atentat kundër PD-së⁵², i dha kësaj

ç'të duan ata se atë punë kanë, patronazhimi është klasa e parë e shkollës së madhe politike, ku kush ambicien për të shkuar në klasa më të larta e fillon nga patronazhimi. Mesazhi im për ata që merren me patronazhistët, duke filluar nga Ilir Meta, ku është kamera? Patronazhistëve t'ju merrni të keqen! Mos harroni: Patronazhistët ju njohin kush jeni, as mos ta çoni nëpër mend se patronazhistët tanë ja fshini mendimet tuaja. Ne ju njohim kush jeni dhe në 25 prill do ta shikoni sa mirë ju njohim ne juve”.

Reagime të ashpra për këtë çështje pati edhe nga kreu i shtetit Ilir Meta dhe Partia Demokratike, të cilët e cilësuan këtë një krim që vinte në rrezik të dhënat personale të qytetarëve.

⁴⁹ [Deklaratë e Drejtoreshës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit \(AKSHI\), Linda Karçanaj](#) “Të dhënat e qytetarëve shqiptarë që marrin shërbime online përmes portalit unik qeveritar e-Albania nuk ruhen dhe as nuk janë ruajtur ndonjëherë, as nga AKSHI e as nga e-Albania. Përveç ndalimit nga legjislacioni në fuqi, nuk ekziston asnjë mundësi teknike që këto të dhënat të përdoren e keqpërdoren, kur as nuk ruhen dot.”

⁵⁰ Në datë 18 Prill 2021, u dogj makina e kryetarit të grupseksionit të Partisë Demokratike në Shëllqet, të Bashkisë Vau i Dejës, Ariston Drin ([Raportim i A2 CNN 18.04.2021](#))

Në datë 21 Prill 2021, në Poliçan u raportua se një anëtar i LSI Poliçan, Luan Tare Pitikoja, anëtar i LSI u godit me sende të forta, duke pretenduar se sulmi ishte politik. ([Raportim i A2 21.04.2021](#))

⁵¹ [Deklarata e Policisë së Shtetit 20 prill 2021](#) “Sot rreth orës 19:00, në lagjen nr. 4, në Kavajë, shtetasi N. J., dyshohet se si pasojë e një konflikti për motive të dobëta, ka hyrë në ambientet e brendshme të një zyre elektorale të një subjekti politik dhe ka plagosur me armë zjarri pistoletë në këmbë shtetasin B. O., 27 vjeç, i cili ndodhet në spitalin e Durrësit, nën kujdesin e mjekëve.”

⁵² [Lulzim Basha në një deklaram për mediat fill pas ngjarjes në Kavajë](#) “Sonte Kavaja është përballur me një ngjarje të rëndë, një atentat kundër PD-së, kundër Aleancës për Ndryshim nga një kryeministër që e di se të dielën ai humb, Kavaja fiton dhe Shqipëria fiton... Kërkojnë të frikësojnë PD-në, kërkojnë të na mbyllin gojën, nuk kemi frikë, do të marrin përgjigjen e merituar me votë të dielën në Kavajë dhe në të gjithë Shqipërinë”

ngjarje një natyrë të fortë politike. Nga ana tjetër Kryeministri Rama, nëpërmjet një postimi në mediat sociale e dënoi aktin dhe bëri thirrje për mospolitizimin e situatës⁵³.

Akuzat për blerje vote dhe konfliktet mes strukturave të partive kryesore, do të shkaktonin në Elbasan një ngjarje të rëndë e cila rezultoi në humbjen e një jete dhe plagosjen e katër personave të tjerë⁵⁴. Ngjarja, e cila ishte tërësisht me motive politike, krijoi një situatë tensioni në vend, e ndërsa asnjë nga palët nuk u distancua nga ngjarja, por akuzuan njëra-tjetrën si shkaktare të saj⁵⁵.

Madje tensioni i krijuar do të rëndohej më tej, kur kandidati për deputet në Qarkun e Dibrës, kërcënoi se çdo person që prekte një votë do të përfundonte në viktimitë, njësoj si në ngjarjen e Elbasanit⁵⁶. Pavarësisht, ndjesës së kërkuar nga kandidati për deputet⁵⁷ ndaj tij nisi procedimi penal nga policia për “thirrje të armatosur”⁵⁸, duke u hetuar në gjendje të lirë.

⁵³ [Edi Rama në një postim në Twitter](#): “Plagosja e Kavajës e patolerueshme! Autori duhet çuar në pranga sa më shpejt! Politizimi i kësaj ngjarjeje është po aq i keq sa vetë ngjarja! LB duhet të bashkohet me mua për të mbështetur drejtësinë pa nxitur tensionin, ndërsa IM duhet ta ndalë fushatën idioteske të tensionimit!”

Ngjarja e cila pati zhvillime të mëtejshme, nëpërmjet shpërndarjes në mediat sociale të një reagimi të autorit në arrati të kësaj ngjarje, ku shpjegonte se arsyet e konfliktit nuk kishin shkaqe politike por një konflikt të rastit, nuk e anashkaloi debatin politik. Mediat shpërndanë video që tregonin zotin Basha në organizim të një aktiviteti elektorale në ambientet në pronësi të autorit të ngjarjes, ndërsa kjo solli edhe reagimin e Ramës.

Edi Rama në një postim në Twitter: “Është krejt e qartë që ngjarja e Kavajës s'ka asnjë motiv politik! Autori s'ka asnjë lidhje me PS, përkundrazi është militant i PD! PD s'ka faj për ngjarjen po për politizimin skandaloz! Lulëzim bëhu burrë, ndahu nga Iliri e Salii, boll bëre kukullën e të paudhëve pa din e iman!”

⁵⁴ [Deklarata e Policisë së Shtetit, në datë 22 Prill 2021](#) për vrasjen e një personi, në qytetin e Elbasanit dhe plagosjen e katër të tjerëve, për shkak të përplasjeve mes përfaqësuesve të strukturave për mbrojtjen e votës dhe përfaqësuesve kriminale, të akuzuar nga PD, si të lidhur me Partinë Socialiste.

⁵⁵ Drejtuesi politik i PD në Elbasan, Gazment Bardhi në një deklaratë për median 21 Prill 2021 “... Konflikti politik i nxitur nga Partia Socialiste që prodhon tension çdo moment, në përpjekjen për të mbajtur pushtetin me çdo kusht, dhe për të mos lënë qytetarët të votojnë të lirë....Ajo që ka ndodhur sot është drejtpërdrejtë përgjegjësi e Taulant Ballës. Angazhimi i eksponentëve të krimit të organizuar në zgjedhje dhe nxitja për të kryer krime elektorale është përgjegjësi e tij”.

Edi Rama në një postim në Twitter në 21 Prill “Dëshpërimi i humbësve nuk duhet e nuk do të na bëjë të humbasim as qetësinë, as durimin, as besimin se 25 prilli do të sjellë bashkimin e shqiptarëve për ta ngjitur Shqipërinë në majën e merituar dhe ndëshkimin kuptimplotë të forcave që duan të ribëhen gjarpër rreth këmbëve tona!”

⁵⁶ Drejtuesi politik i PD, në Dibrë Xhelal Mziu [gjatë një takimi me qytetarët](#) thotë se PD deklaroi “Kemi ngritur grupet e gatshme nga sot dhe në vazhdim dhe çdo person i dyshimtë që lëviz në lagjet tuaja, mjafton një telefonatë dhe do ta pësojë njëllon si ai i Elbasanit”.

⁵⁷ Në deklaratën e tij kandidati për deputet Xhelal Mziu shprehu keqardhje për deklaratën e nxituar “Me sinqeritetin më të madh, shpreh keqardhjen time dhe pendesën time për komentin tim të panevojshëm dhe, për shkak të emocioneve të forta të momentit...”

⁵⁸ [Deklaratë e Policisë së Dibrës 23 Prill 2021](#)– Nga Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibrë ka filluar procedimi penal dhe materialet hetimore janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibrë, për veprën penale “Thirrjet për armatosje ose marrje të padrejtë të komandës”, në ngarkim të shtetasit XH. M., kandidat për deputet i subjektit politik Partia Demokratike në qarkun Dibrë.

V.2. PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE PËR PËRFITIM ELEKTORAL

Në takimet elektorale të zhvilluara është vërejtur një prani e konsiderueshme e zyrtarëve të lartë të administratës publike, të cilët kanë qenë të shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë lokalë⁵⁹. Përveç faktit që kanë qenë të pranishëm në këto aktivitete elektorale përgjatë orarit zyrtar të punës⁶⁰, një pjesë e tyre kanë qenë të angazhuar në evente edhe si folës dhe protagonist, çka përbën shkelje të kuadrit ligjor zgjedhor⁶¹ apo edhe të statusit të nënpunësit publik.

Pranë vëzhguesve të KRIIK, prej punonjësve të administratës publike në nivel lokal, janë paraqitur pretendime për presione të ushtruara t'u angazhuar në fushatë, në formën e pjesëmarrjes aktive apo edhe për të siguruar votues për forcën politike qeverisëse. Pretendime të tilla përfshijnë edhe shantazhe apo intimidim për pushim nga puna apo mospërfitim të shërbimeve sociale.

Gjithashtu, një shqetësim tjetër i vërejtur është pjesëmarrja e të miturve në eventet elektorale, të shoqëruar nga familjarë si pjesë e audiencës⁶² apo duke mbajtur të veshur simbole⁶³ partiake apo të fushatës.

Maxhoranca përdori për qëllime të fushatës provimin e një sërë veprash publike, si aeroporti i Kukësit, projekti për ndërtimin e portit të Durrësit, Vlorës dhe Sarandës, promovimi i punimeve në unazën e madhe të kryeqytetit, punimet e Rugës së Arbrit punimet dhe promovimi i spitalit rajonal të Fierit , e të tjera⁶⁴, të gjitha këto në kundërshtim me ligjin zgjedhor.

Përkrah fushatës elektorale, në vend gjatë kësaj periudhe u zhvillua edhe fushata e vaksinimit të popullatës nga virusi i Covid-19. Fushata e vaksinimit u përdor në mënyrë masive në funksion të fushatës elektorale, duke mos u ndarë dot në natyrë si një fushatë institucionale, detyrim i institucioneve shëndetësore dhe qeverisë së shtetit shqiptar për të vaksinuar dhe siguruar shëndetin e popullsisë.

⁵⁹ Zyrtarë të lartë lokalë të cilët kanë qenë të pranishëm në takime elektorale janë evidentuar në bashkinë Kamëz, bashkinë Tiranë, bashkinë Vau i Dejës, Bashkia Fushë-Arrëz, Krujë, Bashkia Durrës, Bashkia Fier, Bashkia Korçë, Bashkia Elbasan, Bashkia Kukës, Bashkia Vorë, Bashkia Lushnjë, Bashkia Vlorë, Kurbin.

⁶⁰ Zyrtarë të lartë lokalë në Bashkitë Vorë, Krujë, Tiranë, Vlorë, Bulqizë.

⁶¹ Vendimi nr.9, dt. 24.12.2020 i Komisionit Rregullator mbi “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

⁶² Pjesëmarrja e të miturve si pjesë e audiencës është evidentuar në takimet elektorale të zhvilluara në bashkitë Fier, Kamëz, Krujë, Roskovec, Elbasan, Kukës, Durrës, Kuçovë, Lezhë, Dibër, Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Vorë, Laç, Mirditë, Tiranë.

⁶³ Bashkia Elbasan, Tiranë, Vlorë, Dibër, Tiranë, Gjirokastrë, Patos, Roskovec, Lezhë, Kamëz, Vorë.

⁶⁴ Janë vërejtur një sërë aktiviteteve ku ministrat inspektojnë apo promovojnë investime apo punime gjatë periudhës së fushatës elektorale dhe, ku ka prani simbolesh dhe thirrjesh elektorale. P.sh. [Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale](#)- Promovim
[Ministrja e Infrastrukturës dhe Transportit](#)-Promovim
[Ministrja e Kulturës](#)-Promovim.

Është konstatuar se në periudhën kohore 26 mars - 13 prill, Kryeministri ka zhvilluar një sërë aktiviteteve elektorale, në orar zyrtar, të cilat në KQZ janë raportuar si "*Takime informuese*", "*Bashkëbisedim me qytetarë*", "*Takim me biznese*", "*Inspektime*", etj., dhe jo si takime elektorale⁶⁵. Më pas, prej datës 14 prill, aktivitetet e këtij lloji janë raportuar në KQZ si takime elektorale dhe janë zhvilluar po përgjatë orarit zyrtar⁶⁶.

Në të njëjtën periudhë kohore dhe ministrat kanë zhvilluar një sërë aktiviteteve elektorale, që në KQZ janë raportuar si "*Takime informuese*", "*Bashkëbisedim me qytetarë*", "*Takim me biznese*", "*Inspektime*" dhe jo si takime elektorale⁶⁷.

Nga monitorimi i aktiviteteve të bashkive, rezulton se dhe kryebashkiakët kanë zhvilluar aktivitete elektorale në orarin zyrtar, përgjatë gjithë periudhës së fushatës elektorale, por nuk i kanë raportuar fare ato në KQZ⁶⁸.

⁶⁵ Aktivitete elektorale të kryeministrit, në orar zyrtar, që në KQZ janë raportuar si "*Takime informuese*", "*Bashkëbisedim me qytetarë*", "*Takim me biznese*", "*Inspektime*" (Periudha kohore 26 mars-13 prill):

[Data 03.04.2021](#)-Takim elektoral në qarkun Fier;

[Data 06.04.2021](#)-Takim elektoral në Korçë;

[Data 08.04.2021](#)-Takim elektoral në Dropull;

[Data 09.04.2021](#)-Takim elektoral në Sarandë;

[Data 10.04.2021](#)-Takim elektoral në Vlorë;

[Data 12.04.2021](#)-Takim elektoral në qarkun Elbasan;

[Data 12.04.2021](#)-Takim elektoral në qarkun Elbasan;

[Data 13.04.2021](#)-Takim elektoral në qarkun Elbasan;

[Data 13.04.2021](#)-Takim elektoral në Tiranë;

⁶⁶ Aktivitete elektorale të Kryeministrit, në orar zyrtar, që në KQZ janë raportuar si "*Takime elektorale*" (periudha kohore 14 prill-23 prill):

[Data 14.04.2021](#)-Takim elektoral në Tiranë;

[Data 15.04.2021](#)-Takim elektoral në Tiranë;

[Data 16.04.2021](#)-Takim elektorale në Tiranë;

[Data 07.04.2021](#)-Takim elektoral në Durrës;

[Data 19.04.2021](#)-Takim elektoral në Peqin;

[Data 20.04.2021](#)-Takim elektoral në Tiranë;

[Data 21.04.2021](#)-Takim elektoral në Fushë-Krujë;

[Data 21.04.2021](#)-Takim elektoral në Tiranë.

⁶⁷ Aktivitete elektorale të ministrave, të raportuara në KQZ si "*Takime informuese*", "*Bashkëbisedim me qytetarë*", "*Takim me biznese*", "*Inspektime*":

[Ministri i Mbrojtjes](#), Niko Peleshi-Takim elektoral në Pogradec;

[Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi](#)-Takim elektoral në Skrapar;

[Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj](#)-Takim elektoral në Durrës.

⁶⁸ Aktivitete elektorale të kryetarëve të bashkive, në orar zyrtar, që nuk janë raportuar në KQZ:

[Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj](#)-Takim elektoral në Tiranë;

[Kryetari i Bashkisë Devoll, Eduard Duro](#)-Takim elektoral në Bilisht;

[Kryetari i Bashkisë Dropull, Dhimitraq Toli](#)-Takim elektoral në Dropull;

[Kryetari i Bashkisë Berat, Ervin Demo](#)-Takim elektoral në Berat;

[Kryetari i Bashkisë Sarandë, Ardian Gurma](#)-Takim elektoral në Sarandë;

[Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Erion Isai](#)-Takim elektoral në Kolonjë;

[Kryetari i Bashkisë Kukës, Safet Gjici](#)-Takim elektoral në Kukës;

[Kryetari i Bashkisë Belsh, Arif Tafani](#)-Takim elektoral në Belsh;

[Kryetari i Bashkisë Cërrik, Andi Salla](#)-Takim elektoral në Cërrik;

[Kryetari i Bashkisë Elbasan, Gledian Llatja](#)-Takim elektoral në Elbasan;

[Kryetari i Bashkisë Kamëz, Rakip Suli](#)-Takim elektoral në Kamëz;

Në portalin e denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në periudhën që mbulon ky raport janë depozituar 23 denoncime, 12 prej të cilave të depozituara nga qytetarë, 10 nga institucione⁶⁹ dhe subjekte politike⁷⁰ dhe një nga Presidenti i Republikës. Vlen të theksohet se 10 denoncime me denoncues qytetarë janë përcjellë në KQZ nga institucioni i Presidentit të Republikës.

Objekti i denoncimeve konsiston në emërime/largime/transferime punonjësish, materiale propagandistike, përdorimi i burimeve publike dhe mospërbushje detyrimi.

Lidhur me denoncimet e sipërpërmendura KSHZ ka konkluduar me 23 vendime. Në vetëm një rast është vendosur⁷¹ sanksion administrative me gjobë ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë, vendim, i cili ende nuk është i formës së prerë duke qenë se është ankimuar në Kolegjin Zgjedhor. Në 19 raste është konkluduar me përfundim të hetimit administrativ dhe në 3 raste është konkluduar me urdhërim të institucioneve përkatëse për marrjen e masave.

VI. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Duke nisur nga fillimi i marsit, KQZ angazhoi 64 monitorues të fushatës zgjedhore me synim rritjen e transparencës dhe vlerësimin e pavarur të aktiviteteve të fushatës.

Në ndryshim nga viti 2017 dhe viti 2019, monitoruesit e aktiviteteve të fushatës nuk kanë për qëllim të nxjerrin kosto të pavarura të fushatës, por vetëm të monitorojnë aktivitetet, përfshirë aktivitetet e institucioneve shtetërore.

Ky mekanizëm është i rëndësishëm gjatë periudhës parazgjedhore, me qëllim rritjen e transparencës për zgjedhësit, ndërkohë që gjetjet e monitoruesve do të shërbejnë edhe si informacion shtesë për evidentimin e saktësisë së raportimit të shpenzimeve të fushatës nga vetë subjektet zgjedhore. 64 ekspertët monitorues mbulojnë të 12 qarqet e vendit.

[Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, Flamur Golemi](#)-Takim elektorale në Gjirokastrë;

[Kryetari i Bashkisë Librazhd, Kastriot Gurra](#)-Takim elektorale në Librazhd;

[Kryetari i Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu](#)-Takim elektorale në Lezhë;

[Kryetari i Bashkisë Dibër, Dionis Imeraj](#)-Takim elektorale në Peshkopi;

[Kryetari i Bashkisë Fier, Armando Subashi](#)-Takim elektorale në Fier;

[Kryetari i Bashkisë Kavajë, Redjan Krali](#)-Takim elektorale në Kavajë;

[Kryetari i Bashkisë Lushnjë, Fatos Tushe](#)-Takim elektorale në Lushnjë;

[Kryetari i Bashkisë Peqin, Lorenc Tosku](#)-Takim elektorale në Peqin;

[Kryetari i Bashkisë Përfaqësues, Nuri Belba](#)-Takim elektorale në Elbasan;

[Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, Edison Memolla](#)-Takim elektorale në Rrogozhinë;

[Kryetari i Bashkisë Shijak, Elton Arbana](#)-Takim elektorale në Shijak;

[Kryetari i Bashkisë Vorë, Gentian Picari](#)-Takim elektorale në Vorë.

⁶⁹ Qendra Muzeore Durrës, bashkia Roskovec.

⁷⁰ 1 denoncim nga LSI dhe 6 denoncime nga PD.

⁷¹ [Vendim nr. 234 datë 14 prill 2021.](#)

Publikimi i raporteve të monitorimit në faqen e KQZ-së ka qenë thuajse inekzistent në përgjithësi dhe totalisht i munguar gjatë fushatës zgjedhore, çka ka sjellë transparencë të reduktuar, mbi një mekanizëm i cili ishte jo eficient qysh në ngjizjen e vet⁷².

Aktualisht, mund të konkludohet se mekanizmi i cili synon rritjen e transparencës mbi aktivitetet e fushatës zgjedhore dështoi të arrijë funksionin e vet primar, transparencën në funksion të zgjedhësve. Mbetet për t'u vlerësuar nëse në vazhdim gjetjet e monitoruesve do të mund të përdoren në mënyrë eficiente nga administrata e KQZ-së për verifikimin e raporteve të subjekteve zgjedhore.

Kuadri ligjor nuk i detyron subjektet zgjedhore të bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet përpara ditës së zgjedhjeve dhe asnjë prej subjekteve nuk ofroi transparencë vullnetare në lidhje me këtë, megjithëse KRIIK e kërkoi këtë nëpërmjet një Konferencë për Shtyp të bërë më datë 11 Mars 2021.

Aktualisht, i vetmi shpenzim i fushatës zgjedhore që mund të bëhet transparent në mënyrë të pavarur, janë shpenzimet për reklama në Facebook, falë mekanizmit të transparencës të ndërtuar nga vetë rrjeti social në lidhje me reklamën politike⁷³.

Gjatë periudhës kalendarike që përkon me një pjesë të fushatës zgjedhore dhe pak ditë para saj⁷⁴, në total janë shpenzuar rreth 20.5 milionë lekë për reklama politike në Facebook⁷⁵. Nga këto, 54% (rreth 11.2 milionë lekë) janë shpenzuar për reklama për llogari të Partisë Socialiste dhe 32% (rreth 6.6 milionë lekë) për llogari të Partisë Demokratike. Të gjitha subjektet e tjera zgjedhore kanë shpenzuar shuma shumë më të vogla⁷⁶.

Reklamën janë gjeneruar nga faqet zyrtare të kandidatëve, faqet zyrtare të partisë si dhe nga faqet e degëve të partisë në rrethe.

Aktivitetet elektorale të kryeministrit, në orar zyrtar, që në KQZ janë raportuar si "*Takime informuese*", "*Bashkëbisedim me qytetarë*", "*Takim me biznesë*", "*Inspektim*" (Periudha kohore 26 mars-13 prill):

[Data 03.04.2021](#)-Takim elektorale në qarkun Fier;

[Data 06.04.2021](#)-Takim elektorale në Korçë;

[Data 08.04.2021](#)-Takim elektorale në Dropull;

[Data 09.04.2021](#)-Takim elektorale në Sarandë;

[Data 10.04.2021](#)-Takim elektorale në Vlorë;

[Data 12.04.2021](#)-Takim elektorale në qarkun Elbasan;

[Data 12.04.2021](#)-Takim elektorale në qarkun Elbasan;

[Data 13.04.2021](#)-Takim elektorale në qarkun Elbasan;

[Data 13.04.2021](#)-Takim elektorale në Tiranë.

⁷² Rezultojnë të publikuara në faqen e internetit të KQZ-së 96 raporte monitorimi në total, që mbulojnë periudhën nga 1 deri në 20 mars 2021. Nga këta 63 janë raportet e parë dhe vetëm 33 raporte të dytë të monitorimit.

⁷³ Shih [librarinë e reklamave politike të Facebook për Shqipërinë](#).

⁷⁴ Libraria e reklamave të Facebook nuk lejon detajim të saktë të datave por ka disa alternativa të parapërcaktuara që kufizojnë periudhën kohore për të cilat mund të shihen reklamën. Specifikisht, për këtë raport janë përdorur të dhënat nga data 21 mars në 19 prill 2021, të cilat janë data më pranë periudhës zgjedhore që lejon sistemi i librarisë së Facebook.

⁷⁵ Në përllogaritja janë përfshirë vetëm reklamues që kanë shpenzuar së paku 100 dollarë amerikanë për reklama përgjatë periudhës së përmendur, pasi shpenzimet nën këtë shumë nuk përcaktohen me saktësi por me rang (më pak se 100 dollarë amerikanë) çka e bën të pamundur të qartësohet sa është shuma e shpenzuar saktësisht.

⁷⁶ Lëvizja Socialiste për Integritet, 5.89%; Bindja Demokratike, 3.25%; Partia Socialdemokrate, 1.91%; Nisma Thurje, 1.76%; Lëvizja për Ndryshim, 0.46%; Kandidati i pavarur në Qarkun Dibrë, Elton Debreshi, 0.06%.

Shumica e shpenzimeve për reklama kanë synuar zgjedhësit në Qarkun e Tiranës (47% e totalit të shpenzimeve janë bërë duke synuar zgjedhës në këtë qark), ndjekur në largësi nga Elbasani dhe Shkodra⁷⁷.

Ajo çka përbën një shqetësim madhor është gjenerimi i reklamave nga palë të treta, faqe në Facebook jo të afiluara në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndonjë nga partitë politike, çka me shumë gjasë nuk do të raportohet si pjesë e shpenzimeve të një subjekti zgjedhor në përfundim të fushatës zgjedhore.

Fushata hije vazhdon të jetë një fenomen shumë shqetësues dhe një nga mënyrat për të fshehur shpenzimet e fushatës zgjedhore. Të dhënat nga Facebook janë një ilustrim i këtij fenomeni për të cilin KRIIK ka ngritur në vazhdimësi shqetësimin e tij.

Në këto zgjedhje evidentohen tetë faqe në Facebook të cilat kanë gjeneruar reklama me pagesë, pavarësisht se nuk janë të afiluara drejtpërdrejt me asnjë forcë politike. Nga këto gjashtë faqe kanë gjeneruar reklama për Partinë Socialiste⁷⁸, një për Partinë Demokratike⁷⁹ dhe një për Bindjen Demokratike⁸⁰. Thua se të gjitha këto faqe, me përjashtim të njërës janë krijuar rishtas, çka është indikacion për struktura inautentike të prezencës në *Facebook*.

Veçanërisht shqetësuese është fenomeni i fushatës hije në rastin e gjashtë faqeve që mbështetin Partinë Socialiste, të cilat në total kanë shpenzuar 34% të totalit të shpenzuar për reklama në favor të kësaj partie në Facebook.

VII. MEDIA

Përgjatë fushatës zgjedhore, mediat audiovizive kanë detyrimin ligjor⁸¹, që të jenë të balancuara në pasqyrimin e fushatës dhe aktivitetit të subjekteve zgjedhore. Mediat e tjera, si ato të shkruara dhe

⁷⁷ Elbasan, 9%; Shkodër, 8%; Durrës, 8%; Fier, 7%; Vlorë, 5%; Korçë, 5%; Berat, 3%; Dibër, 3%; Lezhë, 2%; Gjirokastrë, 1% dhe Kukës, 1%.

⁷⁸ - [Socialistët](#), faqe e krijuar në janar të vitit 2021.

- [Untold Stories of Albania](#), faqe e krijuar në janar të vitit 2019 që nuk ka patur karakter politik nga janari deri në maj të vitit 2019. Prej majit 2019 faqja ka qenë inaktive dhe është riaktivizuar në mes të dhjetorit 2020 duke nisur të postojë reklama denigruese ndaj opozitës.

- [Punë](#), faqe e krijuar në shtator të vitit 2020.

- [Ligj dhe Rend](#), faqe e krijuar në nëntor të vitit 2020.

- [Te jesh grua](#), faqe e krijuar në nëntor 2020.

- [Pakëz drite](#), faqe e krijuar në shtator të vitit 2020.

⁷⁹ [Demokratët e Tiranës](#), faqe e krijuar pak ditë para se fushata zgjedhore të niste, në 19 mars 2021.

⁸⁰ [Egnatia Neës](#), faqe e krijuar në nëntor të vitit 2020. kjo faqe është një faqe e një medie online (egnatianeës.com), portal i cili është krijuar në nëntor të vitit 2020.

⁸¹ [Kodi Zgjedhor](#) Neni 80 Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore në radiotelevizionin publik (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012),

Neni 81 Edicionet informative të radiotelevizionit publik (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012), Neni 82 Minutazh falas për KQZ-në,

Neni 83 Orari i transmetimeve,

online, nuk e kanë këtë detyrim, megjithatë përmbajtja e tyre duhet të jete në përputhje me Kodin e Etikës të Gazetarisë⁸².

Mediat tradicionale dhe ato online u treguan mjaft aktive në mbulimin e fushatës elektorale në vend, me pasqyrimin e aktiviteteve elektorale dhe prezantime të kandidatëve që garojnë në këto zgjedhje.

Por ajo çka mbetet ende një shqetësim në media, e sidomos ajo audiovizive, janë transmetimi i materialeve filmike, të cilat vijnë të përgatitura nga shtabet elektorale të partive politike. Kjo teknike e partive politike, por dhe një pamundësi e medias për t'i ndjekur nga afër këto aktivitete, zbehu qasjen kritike dhe filtrin që duhet të vendosë vetë media ndaj mesazheve që të përpunuara në materialet propagandistike. Duhet theksuar se raporti delikat i medias me politikën dhe veçanërisht lidhja mes tyre bëhet më e dukshme përgjatë fushatave elektorale.

Fushata elektorale, duket se i zbuti disi tonet e aktorëve politike, për sa i përket sulmeve ndaj medias. Megjithatë u evidentuan raste sporadike të përmendjes së medias si një pushtet i kapur nga politika apo edhe raste të sulmeve ndaj gazetarëve apo mediave⁸³.

Ndërkohë vendimi i Gjykatës së Posaçme AntiKorrupsion i cili detyronte portalin Lapsi.al të dorëzonte serverët për shkak të publikimit të lajmit investigativ, mbi databazën e përdorur nga Partia Socialiste, me të dhëna personale të 910 mijë qytetarëve të Tiranës, ishte një rast i ndërhyrjes së hapur të institucioneve mbi lirinë e medias. Drejtuesit e këtij portali e quajtën këtë kërkesë për bllokim si një vendim të drejtuar nga strukturat qeveritare⁸⁴. Çështja e mbrojtjes së burimit të informacionit, dhe lirisë së shprehjes së medias, ishin dy parimet themelore që i dhanë të drejtë portalit “Lapsi.al”, në Gjykatën e Strasburgut për të mos dorëzuar serverët ku ruhen materialet e portalit informativ⁸⁵.

Neni 84 Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, shtuar shkronja “d” e pikës 2, ndryshuar akronimi dhe ndryshuar afati në pikën 10 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020), Neni 84/1 Mbulimi i fushatës zgjedhore në zgjedhjet vendore (shtuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012), Neni 85 Monitorimi i fushatës zgjedhore në media (ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 dhe shfuqizuar pika 5, me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)

⁸² Kodi më i fundit i etikës është hartuar më 2018 nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen e Projektit për Riforcimin e Ekspertizës Juridike në Lirinë e Shprehjes dhe të Medias në Evropën Juglindore (JUFREX) – një iniciativë e përbashkët e udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës ([shih Kodi i Etikës së Gazetarit](#))

⁸³ Mbështetës të Kryetarit të Bashkisë Erion Veliaj, nuk lejuan gazetarin e Ora t'i drejtonte disa pyetje gjatë një takimi të tij me banorët e Kavajës, duke e larguar atë me forcë dhe dhunuar grupin e xhirimit. [Raportim i Ora 14 Prill 2021 "E paprecedentë/ Kavajë mbështetësit e Veliajt dhunojnë gazetarin dhe grupin e xhirimit të Ora"](#) Ajo çka mbetet shqetësues është fakti i mos distancimit të zyrtarëve politikë nga dhuna. E në të njëjtën kohë, pamjet e publikuara në media, treguan shqetësimin e përhershëm të medias, që ka të bëjë me moslejimin e tyre në aktivitete elektorale. Ndalimi i tyre, për të kryer të drejtën e tyre kushtetuese të informimit dhe dhënies së informacionit, nuk e ndihmon aspak raportin e politikës me median, duke e detyruar të mos përmbushë misionin e saj.

⁸⁴ [Raportim i Lapsi.al Armand Shkullaku](#) “Ne nuk mund të punojmë në redaksinë tonë. Ne përsëri refuzuam oficerëve të policisë gjyqësore të hyjnë në zyrat tona. U thamë: nëse duan të hyjnë në zyrat tona, të shkojnë e t'i shpërthejnë. Ne vet nuk dorëzojmë materiale, sepse e quajmë këtë një dhunim të lirisë së shprehjes. I kërkuam dy ditë kohë të konsultohemi edhe ne me avokatët tanë. Vendimi i gjyqtarës na duket i tepruar, sepse duket më tepër i motivuar nga urdhër nga lart se sa nga një hetim i vërtetë nga poshtë. Besojmë që në këtë rast prokuroria nuk po përdoret për qëllimin për të cilin është krijuar, po ashtu edhe Gjykata Speciale”

⁸⁵ [Raportim i Lapsi.al](#) “Gjykata e Strasburgut mbron Lapsi.al. SPAK nuk ka të drejtë ta sekuestrojë”

VII.1. Media audiovizive

Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) paraqiti nëpërmjet raporteve ditore dhe atyre javore matjet cilësore dhe sasore të pasqyrimin të fushatës elektorale në këto media⁸⁶.

Bazuar në kapacitet teknike të monitorimit, AMA monitoroi përmbajtjet programore të 36 OSHMA-ve. Nga këto 27 kanale (23 TV dhe 4 Radio) ishin në monitorim të përhershëm nga AMA 18 kanale, ndërsa 9 subjekte u përfshinë sipas përzgjedhjes së përcaktuar nga KQZ. Në këto raporte, u monitoruan koha e transmetimit të secilit subjekt zgjedhor dhe aktor politik, në edicionet informative, transmetimet live, emisionet me përmbajtje politike, radha e vendosjes së kandidatëve si dhe raporti gjinor i mbulimit mediatik të kandidatëve.

Në këto raporte, në tërësi, u vu re mosrespektimi i një sërë detyrimesh ligjore prej OSHMA-ve duke zhbilancuar pasqyrimin mediatik të fushatës zgjedhore të subjekteve elektorale, siç ishin, mosbalancimi i minutazhit për subjektet zgjedhore, kapërcimi i hapësirës së lejuar të transmetimit të reklamave politike, mosdorëzimi i materialeve të kërkuara nga AMA, apo dhe transmetimi edicioneve informative në një media nga një media tjetër.

Në raportet e saj ditore, AMA i bëri thirrje televizione të respektonin detyrimet e tyre, e ndërsa në raportet e saj javore, ajo i sugjeroi KQZ-së masa administrative për shkeljet e përsëritura. Shqetësim vërehet fakti se AMA, si në raportin e parë javor, ashtu edhe në atë dytë, nuk përcaktoi një afat për kompensimin e minutazhit të munguar që disa media mund të kishin ndaj një subjekti zgjedhor. Si e tillë, u vu re se diferenca mes transmetimit të materialeve zgjedhore për një parti apo një tjetër, u rrit, në edicionet informative, dhe jo e kundërta. Mospërcaktimi i këtij afati, bëri që media, të mos merrte hapa të menjëhershme në korrigjimin e këtij minutazhi. Së pari, duke mos respektuar detyrimet e vendosura në Kodin Zgjedhor, e në të njëjtën kohë edhe duke transmetuar informacion të njëanshëm sasior për një parti, apo disa prej tyre.

Në tre raportet javore të publikuar nga AMA për periudhën 26 mars-19 prill 2021 në lidhje me këto monitorime, u vërejt, se minutazhi i dhënë Partisë Socialiste në pushtet në edicione informative, emisione politike dhe transmetime *live* është më i lartë se ai i dhënë për Partinë Demokratike në 19 kanale të monitoruar. Ndërsa në 6 prej tyre, minutazhi ishte në favor të partisë Demokratike.

Radio Televizioni Publik Shqiptar i cili ka një detyrim ligjor primar për të qenë i balancuar, evidentoi se ka disbalancë në raportimet e edicioneve informative⁸⁷.

Në raportin e javës së dytë, vërehet se edhe televizionet kryesore në vend, private kombëtare, të cilat mbulojnë me audiencë një pjesë të madhe të territorit të vendit, i kanë kushtuar Partisë Socialiste më shumë kohë televizive në edicionet e tyre informative sesa Partisë Demokratike. Ndërsa mbetet nën

⁸⁶ [KQZ- Raportet e Monitorimit të Medias 2021](#)

⁸⁷ Nga data 26 Prill deri në 11 prill 2021 RTSH 1 i detyrohej Partisë Demokratike 31 minuta kompensim, LSI 34 minuta dhe PSD 40 minuta. Ndërsa në raportin e tretë javor ky kanal publik i detyroj PD 31 minuta, LSI 92 minuta, ndërsa PSD 106 minuta. Edhe pas miratimit nga KQZ të sugjerimeve nga AMA për tërheqje vëmendje dhe kompensim të minutazhit, në RTSH 1 shifrat e raportit të tretë javor tregojnë se një iniciativë tillë nga televizioni publik nuk u respektua.

minutazhin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor edhe pasqyrimi i kronikave për partitë LSI dhe PSD. Në këtë raport vërehet se të gjitha televizionet, nuk i kanë dhënë hapësirën e përcaktuar asnjërës prej këtyre partive⁸⁸.

Kërkesa e bërë nga KQZ në mbledhjen për miratimin e raportit të dytë javor, përveçse nuk u zbatua nga këto televizione, por vërehet se diferenca në minutazh kundrejt një partie është dyfishuar⁸⁹.

Një ndër treguesit e monitoruar nga AMA kanë qenë edhe reklamat politike, të cilat kanë të njëjtën linjë me pasqyrimin e subjekteve zgjedhore në edicionet informative. Sipas nenit 84 të Kodit Zgjedhor, reklamat politike duhet të identifikojnë qartë subjektin porositës.

Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë fushatës nga secili televizion ose radio nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje. Por megjithatë sipas treguesve të AMA-s, në raportin e dytë javor, 11 televizione e kanë tejkaluar kohën e reklamave politike të parashikuar për të gjithë kohëzgjatjen e fushatës – 9 për subjektin Partia Socialiste, 6 për subjektin Partia Demokratike, ndërsa një prej televizioneve e ka tejkaluar hapësirat për treja partitë kryesore PS, PD dhe LSI.

Ndërsa në raportin e saj të tretë javor, rezultojnë 14 operatorë që kanë kryer këtë shkelje. Ndër to një televizion ka tejkaluar kohën e reklamave politike për pesë parti pjesëmarrëse në zgjedhje⁹⁰ Ndërsa nëntë kanale televizive kanë tejkaluar minutazhin për reklamat vetëm për dy partitë kryesore PS dhe PD⁹¹.

Në favor të vetëm një partie kryesore kanë transmetuar reklama katër televizione⁹². Shqetësues mbetet fakti se në televizionet lokale, në raportet e AMA-s vërehet se disa prej tyre kanë kaluar në shifra të larta minutazhet vetëm për një subjekt zgjedhor⁹³.

⁸⁸ [Raporti për periudhën e monitorimit, për kompensim të minutazhit në edicionet informative 26 mars-3 prill](#)

Top Channel- PD-7 min., LSI-20 min., PSD-20 min.

TV Klan- PD-57 min., LSI-61 min., PSD-73 min.

Vizion Plus- PD-33 min., LSI-39 min., PSD-44 min.

[Raporti javor për periudhën e monitorimit, për kompensim të minutazhit në edicionet informative 4 Prill- 11 Prill](#)

Top Channel- PD-38 min., LSI-53 min., PSD-54 min.

TV Klan- PD-148 min., LSI-147 min., PSD-147 min.

Vizion Plus- PD-53 min., LSI-74 min., PSD-91 min.

⁸⁹ [Raporti javor për periudhën e monitorimit, për kompensim të minutazhit në edicionet informative 12 Prill- 19 Prill](#)

Top Channel- PD-49 min., LSI-82 min., PSD-84 min.

TV Klan- PD-213 min., LSI-237 min., PSD-250 min.

Vizion Plus- PD-76 min., LSI-113 min., PSD-147 min.

⁹⁰ Report TV ka tejkaluar transmetimin prej 90 minutash të përcaktuar nga KQZ për partitë parlamentare dhe 10 minuta për ato jo parlamentare, PD, PS, Nisma Thurje, Bindja Demokratike dhe Lëvizja për Ndryshim.

⁹¹ TV Klan, Top Channel, Vizion Plus, Klan Plus, Klan Ë, Ë 24, Abc Ë, RTV Ora, Euro Ë Balkans

⁹² Tejkallim i minutazhit për Partinë Socialiste: Report TV, Top Ë

Tejkallim i minutazhit në Favor të Partisë Demokratike: Shijak TV, Fax Ë, Syri TV.

⁹³ Raporti Javor I Monitorimit të Medias 26 Mars-3 Prill 2021, TV Alepo ka transmetuar 283.6 minuta në favor të Partisë Binda Demokratike

Raporti Javor I Monitorimit të Medias 4 Prill-11 Prill, One TV Vlora ka transmetuar 479 minuta në favor të Partisë Socialiste, ndërsa TV 6+1 ka transmetuar 193 minuta për PD, 206 për PS dhe 195 minuta për LN

Shkelje të përsëritura, edhe pas tërheqjeve të vëmendjes nga KQZ, ka pasur edhe për transmetimin e reklamave politike jashtë orareve të përcaktuar në kod, transmetimi i tyre pa një logo identifikuese, apo transmetimi i tyre brenda edicioneve informative.

Për sa i përket pasqyrimin të kandidatëve të këtyre subjekteve në të gjitha televizionet e monitoruar nga AMA, liderët e partive kryesore Kryeministri Rama dhe kreu i PD Lulzim Basha kanë zënë hapësirën më të madhe. Shifrat e pasqyrimin për krerët korrespondojnë me të njëjtat si ato të përfaqësimit të subjekteve të tyre politike në edicionet informative në këto televizione.

Ajo çka vihet re në këto raporte, është hapësira e limituar që iu është dhënë prurjeve të reja politike, qofshin këto subjekte zgjedhore apo edhe kandidatë për deputet.

I njëjti shqetësim, shfaqet edhe në përfaqësimin gjinor, kur një pjesë e mirë e televizioneve të monitoruara nuk kanë respektuar përfaqësimin e balancuar gjinor. Një diferencë e ngushtë në këtë aspekt shihet vetëm në disa TV, si ato kombëtare private dhe televizionet publike të marra për monitorim⁹⁴.

Në vendimmarrjen e saj KQZ-ja, si organi, i cili vendos masat administrative për shkeljet e vërejtura nga AMA, në shqyrtimin që i bëri vetëm dy raporteve të para javore, vendosi vetëm një gjobë administrative⁹⁵, ndërsa vendimet e tjera ishin këshillime dhe tërheqje vëmendje.

Shkeljet e përsëritura, edhe pas vendimmarrjes së KQZ, mospërcaktimi i një afati të qartë për kompensimin e minutazhit, ndaj subjekteve zgjedhore, brenda afatit zyrtar të përfundimit të fushatës elektorale, dhe bartja e këtyre shifrave pas mbarimit të saj, tregojnë për një ngërç në funksionimin e këtij modeli monitorimi i cili kërkon që KQZ-ja të marrë dhe të luajë një rol më pro-aktiv dhe garant i barazisë mediatike ndaj subjekteve zgjedhore, sikurse ligji e parashikon.

Qëllimi i monitorimit, zbatimi me efikasitet i mekanizmit të parashikuar, bashkëshoqëruar kjo edhe me sanksionet e parashikuara, përbëjnë garancinë që zgjedhësit do të prezantohen me informacion të balancuar, në mënyrë që të mund të bëjnë një zgjedhje të informuar. Si e tillë edhe vendimmarrja dhe korrigjimi i çdo shkelje nga OSHMA-të duhet të korrespondojë me këtë periudhë, në të cilën qytetari duhet të informohet, së paku, në mënyrë të balancuar, e garantë të së cilës ligji ka vendosur institucionin e AMA-s dhe të KQZ-së.

VII.2. Media e Shkruar

Media e shkruar, ndryshe nga ajo audiovizive nuk rregullohet nga ndonjë ligj i posaçëm, dhe gjithashtu nuk ka përcaktime të parashikuara në Kodin Zgjedhor, për një pasqyrim të balancuar të fushatave zgjedhore. Megjithatë, raportimi i saj duhet t'i përmbahet së pari parimeve të Kushtetutës,

⁹⁴ Televizionet që respektuan hapësirat gjinore, sipas raportit të tretë javor për periudhën 26 Mars-19 Prill: RTSH 1, TV Klan, TV Klan +, Top Channel, Scan, A2, MCN TV, TV Lobi, TV RE.AL dhe TV Channel 1

⁹⁵ Ne [vendimin Nr.257](#) më 21 Prill 2021, KQZ vendosi marrjen e masës administrative, me vlerën 5000 (pesë mijë) lekë, pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 4.4.2021 – 11.4.2021, për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA-të), si më poshtë vijon: - TV Channel 1 - TV Kopliku - TV Antena Nord - TV Klaudiana - TV Skampa - TV Jug - TV Gold - TV Glob - TV Puka - TV Adria Med

dhe Konventës Kombëtare të Drejtave të Njeriut për Lirinë e Shprehjes⁹⁶ dhe gjithashtu edhe Kodit të Etikës së Gazetarisë.

Pavarësisht faktit se kjo media nuk detyrohet me ligj që të jetë e balancuar, ajo duhet të garantojë një informim të saktë të qytetarit. Linja e saj editoriale nuk mund të ndërhyrje në objektivitetin e informacionit të përçarur sidomos përgjatë një fushatë elektorale, ku ndjeshmëria e publikut është edhe më e madhe.

KRIIK vijoi monitorimin e dhjetë gazetave⁹⁷, nga data 27 mars - 23 prill dhe monitorimi sasior konsistonte në matjen me përafërsi në përqindje të hapësirës që zinin në faqet e gazetave, të emërtuara nga redaksia si “Politikë”, të partive politike dhe përfaqësuesve të tyre⁹⁸.

Në këtë hapësirë u morën për matje vetëm lajmet që i kushtoheshin pasqyrimeve të aktiviteteve me karakter elektorale, apo intervistave të përfaqësuesve politikë në të cilat flitej vetëm për zgjedhjet. Qëllimi i këtij monitorimi ishte të evidentonte se çfarë hapësirë zinin pasqyrimet mbi zgjedhjet në fushatën zgjedhore. Gjithashtu, u krye edhe numërimi i titujve të faqes së parë të çdo gazete, dhe sa prej tyre iu kushtoheshin raportimeve mbi zgjedhjet. Qëllimi i këtij monitorimi ishte për të kuptuar klimën që mbizotëron në shtypin e shkruar dhe sa prezentë ishte fushata zgjedhore në faqen e parë të këtyre gazetave, si pasqyrim i drejtpërdrejtë i politikës editoriale të saj.

Nga dhjetë gazeta të monitoruara, u vu re se vetëm 30% e tyre u treguan të balancuara, në pasqyrimin e aktivitetit elektorale të dy partive kryesore, ndërkohë që 40% e tyre kanë një diferencë me 20 % në hapësirën që zë njëra nga dy partitë kryesore në vend. Partia e tretë kryesore në vend, LSI, zë shumicën ose hapësirë të barabartë në faqet politike, krahasuar me PD dhe PS, në 30% të gazetave. Ndërsa në 70% të tyre ajo zë një hapësirë të më pak se 5 % të faqeve të politikës.

Përsa i përket partive të tjera opozitare, pjesëmarrëse në zgjedhje, ato janë shumë pak të përfaqësuara në faqet e politikës së medias së shkruar.

Në total partitë e vogla, nuk zënë në asnjë prej gazetave më shumë se 5 % të hapësirës së pasqyrimin të aktiviteteve elektorale. Madje në 40% të tyre, hapësira që zë pasqyrimi në aktivitetin apo deklaratimeve të Presidentit Meta në lidhje me zgjedhjet, është më e madh ose e barabartë me partitë e vogla.

Faqja e parë e këtyre gazetave, si treguesi kryesor i linjës së tyre editoriale, merr gjithashtu një rëndësi të veçantë përgjatë kësaj periudhe dhe ishte pjesë e monitorimit. Vendosija e titujve në këto gazeta merr një rëndësi edhe më të veçantë, pas hapësirës që i kushtohet leximit të tyre në emisionet e mëngjesit në televizione, duke e rritur potencialisht numrin e lexuesve vetëm të faqes së parë të këtyre gazetave.

⁹⁶ [Konventa Kombëtare e të Drejtave të Njeriut: Liria e shprehjes Neni 10](#)

⁹⁷ 1.Panorama 2.Fjala (Gazetë e përditshme e pavarur) 3.Dita (E përditshme info-analitike) 4.Koha Jonë (E përditshme e pavarur) 5.Gazeta Shqiptare 6.Gazeta Mapo (E përditshme e pavarur) 7.Sot 8.Tema (Gazeta e përditshme) 9. Telegraf (E përditshme e pavarur) 10.Standard (Gazetë e përditshme)

⁹⁸ Në gazetën Tema dhe Mapo, në mungesë të emërimit të faqes “Politike”, u monitoruan faqet e emërtuara si “Aktualitet”. Në gazetën Fjala u përfshinë edhe faqet të emërtuara “Kryesore”

Përgjatë vëzhgimit, është vërejtur, se balanca në përzgjedhjen e titujve që kanë të bëjnë me fushatën elektorale, jo domosdoshmërisht përkon me balancën në brendësi të faqeve politike të gazetës.

50% e gazetave kanë një vendosje tituj të balancuar në faqen e parë për sa i përket forcave kryesore politike, por në 20% e tyre nuk korrespondon me përmbajtje të balancuar, në brendësi të faqeve politike. Përgjatë këtij monitorimi u vu re se në faqet e para të gazetës, titujt kryesorë në 60% të gazetave, kishin të bënin me drejtpërdrejtë me fushatën elektorale. Në 50 % e dhjetë gazetave të monitoruara, kryetitujt ishin një mbështetje e një force politike, ose kishin nota negative ndaj forcës politike kundërshtare.

VII.3. Mediat online

Mediat *online*, përgjatë kësaj fushate elektorale, u shndërruan në një dritare shumë të rëndësishme informacioni për një pjesë të gjerë të shoqërisë.

Larmishmëria e informacionit dhe lehtësia e shpërndarjes së tij për një audiencë më të madhe, i dha kësaj media një vëmendje të veçantë. Informacioni mbi aktivitetet e fushatës zgjedhore, ishte tejet prezent në këto portale me karakter informativ.

Duke mos qenë të detyruara të përdorin materialet zgjedhore propagandistike të partive politike, një pjesë e lajmeve të portaleve vinin nga postimet në rrjetet sociale. Të lira dhe pa kufizime ligjore, për të qenë të balancuara këto media, të motivuara apo jo politikisht, u bënë pjesa më e kritike e fushatës elektorale.

Konkurrenca e këtyre portaleve për numrin e klikimeve, por edhe paqartësitë në financimet e tyre, duke hedhur dyshime për lidhje me subjekte politike, bëjnë që informacioni në to të jetë shpesh një burim kontroversal. Njësoj edhe me saktësinë apo përdorimin e një informacioni, apo deklarate për qëllime politike gjatë kësaj fushate zgjedhore, duke dërguar publikun në drejtime të gabuara⁹⁹.

VII.3.1. Mediat sociale

Ashtu siç ishte vërejtur në edhe në fushatën e parakohshme zgjedhore, duket se betejat kryesore në këtë fushatë elektorale kaloi në rrjetet sociale. Liderët kryesorë, i qëndruan traditës së krijuar edhe në para fushatë me komunikimet *live* me qytetarët, postimet e aktiviteteve të tyre elektorale, fotomontazheve, videove dhe reklamave politike. Beteja e pëlqimeve dhe ndjekësve në transmetimet *live* të liderëve, u bënë edhe kryetituj në portalet shqiptare¹⁰⁰

⁹⁹ Pas transmetimit të një interviste në një studio televizive, Ambasadorja Amerikane Yuri Kim, reagoi nëpërmjet një [postimi në rrjetin social Tëitter](#) duke deklaruar se kishte konstatuar disa tituj të pavërtetë dhe duke i rekomanduar mediave që të dëgjonin edhe njëherë intervistën e saj për të kuptuar.

¹⁰⁰ [Raportim i Report.tv 14 Prill 2021 "Live në të njëjtën kohë, interesi i qytetarëve për kryeministrin Rama 15-fish më i lartë se për kryedemokratën Basha"](#)

Lehtësia që krijojnë këto media, për të reaguar, për të shpërndarë reagimin në mënyrë masive dhe të shpejtë, bëjnë që t'i shërbejnë në mënyrë cilësore shtabeve elektorale të partive politike dhe liderëve të tyre. Komunikimet e rëndësishme u përzgjedhën të bëheshin prej rrjeteve sociale, ndërsa u përdor kjo mënyrë komunikimi nga pothuajse të gjithë aktorët kryesorë.

Rrjetet sociale edhe pse të konsideruara si personale, u përdorën për qëllime publike, jo vetëm nga liderët e partive, por edhe çdo kandidat për deputet në këto zgjedhje. Promovimi i veprave infrastrukturore, postimi i fotove në të cilat shfaqen fëmijët pranë kandidatëve për deputetë ishin disa nga shkeljet që u vunë re në këtë fushatë.

Detyrimi që *Facebook* vendosi për publikimin e kostove të postimeve të reklamave politike, bëri që shpenzimet e kryera prej faqeve të regjistruara të mund të konsiderohen e të bëhen pjesë e raportit të shpenzimeve për fushatën elektorale të partive dhe kandidatëve për deputet.

VIII. ANKESAT DHE APELIMET

Shqyrtimi administrativ i ankesave mbi çështjet zgjedhore gjen rregullim në Pjesën 10 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa përsa i përket shqyrtimit gjyqësor, rregullimi procedural kryhet në Pjesën e 11 të Kodit Zgjedhor. Këto dy të pjesë e kuadrit zgjedhor pësuan amendime relativisht të konsiderueshme përgjatë procesit reformues të vitit 2020. Ndër ndryshimet kryesore përmendet njohja në mënyrë eksplicite e drejtës së ankimit nga të tretë në procesin zgjedhor¹⁰¹.

VIII.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në KQZ janë depozituar 8 ankesa, nga cilat 1 është refuzuar për t'u marrë në shqyrtim¹⁰², 4 janë rrëzuar, 1 u pranua dhe për dy ende nuk ka vendimmarrje të publikuar.

Ankimimi Nr. 7¹⁰³ kishte për objekt vendimmarrjen e Komisionerit për përcaktimin e fondit publik për subjektet zgjedhore. Përpos rregullimit të përgjithshëm, në këto zgjedhje legjislatori kishte parashikuar një formulë specifike¹⁰⁴ mbi fondin publik që do të alokohej në mbështetje të subjekte

¹⁰¹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 124/1, Ankimi administrativ i palëve të treta.

¹⁰² Kërkesa ankimore Nr. 13, depozituar me datë 19/04/2021, ankimues Aleanca për Teatrin; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 22, datë 19/04/2021.

¹⁰³ Kërkesa ankimore Nr. 7, depozituar me datë 25/03/2021, ankimues Koalicioni Bashkimi Popullor; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 13, datë 30/03/2021.

¹⁰⁴ Në Nenin 88 të Kodit Zgjedhor parashikohet rregullimi normë për alokimin e fondeve publike parazgjedhore për subjektet zgjedhore. Me dispozitën tranzitore 180, të ndryshimeve të korrikut 2020, legjislatori parashikonte një formulë specifike përjashtim nga rregulli i përgjithshëm.

zgjedhore. Vlerësohet së këtë rregullim¹⁰⁵, KAS në vendimmarrjen e tij e lexoi drejtë duke rrëzuar kërkesën ankimore të depozituar.

Ajo që mund të përmendet është se rregullimi specifik që ka vendosur legjislatori për këto zgjedhje mbi alokimin e fondit publik është tepër kompleks¹⁰⁶. Për më tepër vlerësohet si i ndërtuar mbi një parim jo të dukshëm, mbi dyshimin e favorizimit të një subjekti specifik, dhe larg rregullimit të përgjithshëm të vendosur në Nenin 88.

Ankimimi Nr. 8¹⁰⁷, 9¹⁰⁸ dhe 10¹⁰⁹, kishin për objekt miratimin e formatit dhe përmbajtjes së fletës së votimit. Këto tre ankime të bashkuara në shqyrtim, kishin më konkretisht për objekt identifikimin e kandidatëve në fletë, orientimin e fletës së votimit dhe logon e një subjekti zgjedhor.

Ndonëse, Komisioni Rregullator miratoi fillimisht specifikimet teknike të fletës së votimit¹¹⁰, me një vendimmarrje të dytë shprehu mungesë kompetence në miratimin të vetë modelit të fletës së votimit¹¹¹. Një qëndrim i Komisionit Rregullator që gjente vend në një teknikë legislative të pasaktë nga legjislatori në rregullimin ligjor të kryer¹¹². Megjithatë, vlerësohet se në lexim të plotë të Kodit Zgjedhor, miratimi i modelit të fletës së votimit ngarkohej mbi Komisionin Rregullator.

¹⁰⁵ Më specifikisht, legjislatori kishte parashikuar dy rrethana kur subjekti zgjedhor do të konsiderohej përfitues nga fondi publik. Sipas kësaj formule, së pari partitë që përfitonin ishin ato që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 2015, në zgjedhjet e 2017, dhe kanë arritur në një prej këtyre zgjedhjeve më shumë se 1%. Gjithashtu përfshiheshin edhe ato parti që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2019, dhe kanë marrë më shumë se 1 % të votave.

¹⁰⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 180, Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti, (...) “1. Zbatimi i nenit 88 të këtij ligji për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të tij bëhet duke kryer përllogaritjet në bazë të rezulttit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. 2. Për secilën parti përfshihet në përllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërin nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse. Në përllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre.”

¹⁰⁷ Kërkesa ankimore Nr. 8, depozituar me datë 01/04/03/2021, ankimes Partia Socialiste; Komisionit i Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimi Nr. 20, datë 19/04/2021.

¹⁰⁸ Kërkesa ankimore Nr. 9, depozituar me datë 01/04/03/2021, ankimes Partia Bindja Demokratike; Komisionit i Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimi Nr. 20, datë 19/04/2021.

¹⁰⁹ Kërkesa ankimore Nr. 10, depozituar me datë 01/04/03/2021, ankimes Partia Demokratike; Komisionit i Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimi Nr.20, datë 19/04/2021.

¹¹⁰ Komisioni Rregullator, Vendimi Nr. 6, datë 26/02/2021, “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

¹¹¹ Komisioni Rregullator, Vendimi Nr. 12, datë 31/03/2021, “Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

¹¹² Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë, Neni 98, Përmbajtja e fletëve të votimit, pika 2, (...) “Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KQZ-së.”

Në rezultante, pas cedimit të Komisionit Rregullator modeli i fletës së votimit u miratua nga Komisioneri¹¹³. Sipas kësaj vendimmarrje, modeli i fletës së votimit kishte orientim horizontal (*landscape*) dhe listimi i kandidatëve kryhej duke përfshirë emërtimin e kandidatëve. Megjithatë, në shqyrtim të ankimeve të paraqitura, KAS rrëzoi këtë vendimmarrje të Komisionerit, duke përcaktuar orientimin vertikal të fletës (*portrait*) dhe listimin numëror të kandidatëve.

Kjo vendimmarrje u mbështet në dy argumente interpretativë të frymës së Kodit Zgjedhor, tërësisht në diskrecionalitet të plotë e të pavend të shumicës së anëtarëve të KAS. Së pari, duke argumentuar që fleta e votimit duhet të kompozohet në mënyrë të lehtë për t'u shënjuar nga votuesit, kështu që modeli me orientim vertikal ishte më i lehtë. Ndërsa përse i përket identifikimit të kandidatëve, u argumentua se Kodi kërkon që fleta e votimit të shërbejë identifikimin e kandidatëve dhe jo ofrimin e informacionit për ata¹¹⁴.

Ky argumentim duke anashkaluar frymën dhe gërmën e ndryshimeve kushtetuese, procesit reformues, Kodit Zgjedhor, për lidhjen dhe votimin e drejtëpërdrejtë të qytetarit me emrin e kandidadit, paplotësisë së elementeve të tjerë informues për një sistem votimi preferencial, si dhe diskrecionaliteti i ekzagjeruar deri në elementë teknikë të mënyrës së votimit, evidentuan qartë një qasje dhe sjellje partizane të tre prej anëtarëve të KAS në linjë me alternativën e mazhorancës socialiste për fletën e votimit.

Ankimimi Nr. 11¹¹⁵ kishte për objekt përcaktimin e partisë politike me të drejtën e përzgjedhjes së anëtarit të katërt në Grupin e Numërimit të Votave¹¹⁶. Ankimesi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet ankimoi vendimin e Komisionerit Shtetëror, i cili përcaktonte Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim si subjekti që e kishte këtë të drejtë të përzgjedhjes së anëtarit të katërt në GNV. KAS me vendimmarrjen e tij e rrëzoi kërkesën duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit. Në arsyetimin e vendimmarrjes së tij, KAS parashtroi tre argumente, për të cilat paraqiten disa kritika.

¹¹³ Komisioneri Shtetëror, Vendimi Nr. 198, datë 01/04/2021, “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

¹¹⁴ Komisionit i Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimi Nr. 20, datë 19/04/2021, (...) “Duket qartë që një K. Zgjedhor që synon identifikimin e kandidatëve me numra dhe jo me emra, parashikon dhe mënyrën e informimit të zgjedhësve për këtë mënyrë identifikimi, duke garantuar që edhe zgjedhësi më i përfshirë në lidhje me procesin dhe kandidatët, të ketë mundësinë që të informohet që në Qendrën e Votimit në lidhje me procesin dhe kandidatët, të ketë mundësinë që të informohet që Qendrën e Votimit në lidhje me mundësitë që ka për përzgjedhjen. Kodi ynë zgjedhor nuk ka asnjë parashikim në lidhje me informimin e zgjedhësve në qendrën e votimit për të identifikuar cili numër i përket një kandidatit konkret.”

¹¹⁵ Kërkesa ankimore Nr. 11, depozituar me datë 02/04/2021, ankimesi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet; Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimi Nr. 20, datë 05/04/2021.

¹¹⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 95, Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave, pika 2, (...) “Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi.”

Së pari, KAS argumentoi se PDIU si pjesë e subjektit zgjedhor Koalicioni për Ndryshim, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor i kalonin partisë drejtuese të koalicionit. Një arsyetim ky që pranohet që gjen relativisht mbështetje tek Neni 65 i Kodit Zgjedhor, që përcakton se “të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.”¹¹⁷. Në këtë drejtim, KAS argumentoi se PDIU nuk gëzonte të drejta si pjesë e koalicionit zgjedhor.

Vlerësohet se për nga teknika legjislative folja “përmbush” nuk është më e sakta në rregullimin e kryer¹¹⁸. Gjithashtu gjykohet se për nga formimi i frazës, pa e njohur vullnetin e legjislatorit, dispozita nuk kupton heqjen e çdo të drejte si ajo e përfaqësimit në trupën e administrimit zgjedhor. Kjo për shkak se fryma e ndërtimit të balancimit në trupën e administrimit zgjedhor lidhet drejtpërdrejtë më përfaqësimit të partisë, përpos çdo afilimi që mund të ketë ai.

Së dyti, në argumentimin e kryer, KAS thërriti në arsyetim vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor në procesin zgjedhor të vitit 2019, në përkufizimin që i bënte subjektit zgjedhor¹¹⁹. Përmbledhtazi në arsyetimin e vendimit të fjalë, argumentohej se nëse subjektet politike “*përsa nuk kanë paraqitur listë kandidatësh, nuk kanë cilësinë e subjektit zgjedhore*”. Kësisoj, sipas KAS edhe PDIU nuk mund të konsiderohej subjekt zgjedhor sepse nuk kishte depozituar lista të vetat shumëëmërore.

Rezerva që shprehet në këtë drejtim është se së pari i referohet një trupe të Kolegjit para Reformës Zgjedhore dhe në një proces zgjedhor ku vendimmarrja e Kolegjit mori kritika të forta. Gjithashtu qasja e vendosur e asaj trupe të Kolegjit dhe e referuar nga KAS, vlerësohet si jo e plotë. Kuadri ligjor zgjedhor nuk e lidh të përkufizimin e subjektit zgjedhor me atributin e propozimit të listave shumëëmërore. Më sa paku, duke ndjekur këtë qasjes formaliste, kjo do të binte në kundërshtim në rastin e vetë kandidatëve në listat shumëëmërore ose të kandidatëve të propozuar nga qytetarët.

Së treti, KAS argumentoi se PDIU nuk kishte interes të ligjshëm në kërkesën e saj për t’u përfaqësues në GNV. Për shkak se sipas KAS subjekti garante vetëm në 5 zona zgjedhore nga 12, u argumentua se PDIU i mungonte interesi për t’u përfaqësuar në administratën zgjedhore. Vlerësohet se ky argumentim i përdorur nga KAS është tërësisht i pambështetur në kuadrin ligjor zgjedhor.

Ankimi Nr. 12¹²⁰ dhe Ankimi Nr. 14¹²¹, ndonëse u pranuan për shqyrtim nga KAS, ende nuk ka një vendimmarrje mbi ankimin.

¹¹⁷ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 65, pika 3, (...) “Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”

¹¹⁸ Arsyetohet se në aspektin jurisprudencial, “të drejtat” kalohen ose transferohen, dhe “detyrimet” zbatohen ose përmbushen. Faza “përmbushja e detyrimeve dhe të drejtave” është jo më korrektja e gjetur.

¹¹⁹ Kolegji Zgjedhor, Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi Nr. 10, paditës Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrit, datë 06/06/2019.

¹²⁰ Kërkesa ankimore Nr. 12, depozituar me datë 15/04/2021, ankimues Partia Drejtësi, Integrit dhe Unitet.

¹²¹ Kërkesa ankimore Nr. 14, depozituar me datë 16/04/2021, ankimues Gentian Picari, Kryetari i Bashkisë Vorë; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

VIII.2. Kolegji Zgjedhor

Pranë Kolegjit Zgjedhor janë depozituar katër ankesa gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ku të gjitha këto u rrëzuan.

Padia Nr. 4¹²² kishte për objekt mos regjistrimin e një subjekti zgjedhor nga Komisioneri Shtetëror, e cila u rrëzua nga Kolegji Zgjedhor. Në vazhden edhe të vendimmarrjes së KAS, vlerësohet se edhe Kolegji Zgjedhor përdori një arsyetim të drejtë.

Padia Nr. 5¹²³ kishte për objekt modelin e fletës së votimit së miratuar nga Komisioneri dhe më pas të ndryshuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Penaliteteve. Kolegji Zgjedhor iu bashkua në argumentet e dhënë nga KAS, por vendosi theksin në një argumentim sërish jo thelbësisht ligjor. Kolegji argumentoi se në thelb mbështeti vendimmarrjen e KAS sepse modeli i propozuar nga Komisioneri do të kërkonte një kohë më të gjatë prodhimi, e cila tejkalonte vetë datën kur priten të mbahen zgjedhjet¹²⁴.

Kjo vendimmarrje e Kolegjit barazoi një diskutim parimor dhe një të drejtë principiale me një argumentim racional teknik, çka nuk është roli dhe misioni i Kolegjit Zgjedhor.

Padia Nr. 6¹²⁵ kishte për objekt përcaktimin e fondit publik parazgjedhor për subjektet zgjedhore. Kolegji Zgjedhor me vendimmarrjen e saj la në fuqi vendimin e Komisionerit Shtetëror dhe KAS.

Padia Nr. 7¹²⁶ kishte për objekt vendimin e Komisionerit për mosregjistrimin e partisë Aleanca Kombëtare. Edhe Kolegji rrëzoi padinë e depozituar për shkak se pala paditëse nuk kishte depozituar paraprakisht ankimim në KAS. Pra, sipas Kolegjit Zgjedhor duke mos ndjekur shqyrtimin administrativ, subjekti kishte humbur të drejtën e shqyrtimit administrativ.

¹²² Padia Nr. 4, depozituar me datë 23/03/2021, ankimuesi Koalicioni Aleanca; Kolegji Zgjedhor, Vendimi Nr.4, datë 31/03/2021.

¹²³ Padia Nr. 5, depozituar me datë 02/04/2021, ankimuesi Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor; Kolegji Zgjedhor, Vendimi Nr. 5, datë 08/04/2021.

¹²⁴ Kolegji Zgjedhor, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, Vendimi Nr. 5, datë 04/04/2021, (...) “Kjo praktikisht e vuri Kolegjin para përgjegjësisë për fatin e zgjedhjeve të 25 prillit, pasi nëse do të pranohej fleta e votimit e miratuar nga Komisioneri, kompanisë prodhuese do t’i duheshin edhe minimalisht 2 javë kohë për të siguruar letrën në përmasat e reja, e më pas të fillonte printimin e tyre dhe transportin në Shqipëri.”

¹²⁵ Padia Nr. 6, depozituar me datë 03/04/2021, ankimuesi Aleanca për Ndryshim; Kolegji Zgjedhor, Vendimi Nr. 6, datë 03/04/2021.

¹²⁶ Padia Nr. 7, depozituar me datë 06/04/2021, ankimuesi Partia Aleanca Kombëtare; Kolegji Zgjedhor, Vendimi Nr. 7, datë 12/04/2021.

Baza ligjore për këtë vendimmarrje ishte Kodi i Procedurës Civile¹²⁷, dhe jo Kodi Zgjedhor. Vlerësohet se argumentimi i Kolegjit përzgjedh një kuadër ligjor paralel duke iu shmangur rregullimit specifik të Kodit Zgjedhor. Ky i fundit e përcakton qartësisht se vendimmarrja për refuzimin e regjistrimit si subjekt zgjedhor ankimohet në Kolegjin Zgjedhor¹²⁸.

IX. VËZHguesIT

Për Zgjedhjet për Kuvendin të 25 prillit 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka akredituar një numër të lartë vëzhguesish jo politikë nga aktorë shqiptarë dhe të huaj.

Gjithësej për këto zgjedhje janë akredituar 201 vëzhgues afatgjatë dhe 1.740 vëzhgues afatshkurtër shqiptarë; 47 vëzhgues afatgjatë dhe 213 vëzhgues afatshkurtër të huaj; si dhe 1.102 përfaqësues të medias.

Kodi Zgjedhor parashikon se vëzhguesit e partive politike apo kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit regjistrohen/akreditohej nga KZAZ-të.

Sa i takon vëzhgueseve të subjekteve politike, 19¹²⁹ KZAZ nuk kanë akredituar vëzhgues partiakë pasi këto të fundit nuk i kanë respektuar afatet ligjore.

¹²⁷ Në vlerësimin e organizatës, arsyetimi i Kolegjit Zgjedhor në referim të Kodit të Procedurës Civile ishte i gabuar.

¹²⁸ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 145, E drejta e ankimit në gjykatë, pika 1, (...) “*Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.*”

¹²⁹ KZAZ 17 Klos, KZAZ 21, 22, 24 Durrës, KZAZ 25 Shijak, KZAZ 33, 34 Tiranë, KZAZ 52 Librazhd, KZAZ 60 Patos, KZAZ 62 Mallakastër, KZAZ 65 dhe 68 Berat, KZAZ 73, 74 Korçë, KZAZ 75 Kolonjë, KZAZ 76 Përmet, KZAZ 78 Memaliaj, KZAZ 81 Libohovë, KZAZ 87 Selenicë.

REKOMANDIME

Nevojitet që Partitë Politike, krerët e tyre dhe gjithashtu institucionet që qëndrojnë mbi palët, duhet të jenë garantë që qytetari të çlirohet nga nxitja e vendimmarrjeve emocionale që vijnë me ashpërsimin e gjuhës, duke bërë thirrje për të ushtruar në mënyrë të lirë e të pandikuar të drejtën e tij të votimit.

Administrata zgjedhore, në të gjitha nivelet, të angazhohet maksimalisht për të garantuar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve, jo vetëm në elementët e vet proceduralë, por edhe në bashkëpunimin eficient me Policinë e Shtetit për garantimin e perimetrit rreth qendrave të votimit, me synim kryesor shmangien e intimidimit të zgjedhësve që mund të ndodhë në afërsi të qendrave të votimit.

Subjektet zgjedhore të evitojnë dhënien e mesazheve me natyrë propagandistike gjatë ditës së heshtjes zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, deri në mbylljen e qendrave të votimit, në mënyrë që të garantohet se zgjedhësit do të shkojnë të votojnë të lirë nga ndikimet e panevojshme dhe të paligjshme.

Subjektet zgjedhore të shmangin prezencën e shtuar dhe të panevojshme të militantëve apo mbështetësve të vet ditën e zgjedhjeve, në mënyrë që qytetarët të mund të votojnë të lirë nga ndikimi i vullnetit të tyre.

Policia e shtetit të angazhohet që të garantojë sigurinë e procesit zgjedhor dhe një klimë të qetë për qytetarët, jo vetëm duke evidentuar dhe ndaluar individë që mund të tentojnë të ndikojnë vullnetin e zgjedhësve, por edhe duke u përpjekur të rrinë larg qendrave të votimit dhe të jenë sa më pak të dukshëm për qytetarët për sa kohë që prezenca e tyre nuk është e nevojshme.

Partitë politike të shmangin zëvendësimin e komisionerëve në të gjitha nivelet, me qëllim që procesi zgjedhor të administrohet në mënyrë eficiente, transparente dhe me profesionalizëm.

Zyrtarët publikë të shmangin prezencën në afërsi të qendrave të votimit apo media dhe evitojnë dhënien e mesazheve me natyrë institucionale të cilat mund të perceptohen nga zgjedhësit si mesazhe propagandistike.

Media të mbajë një qasje korrekte dhe të paanshme gjatë periudhës së mbetur deri në mbylljen e qendrave të votimit, të raportojë me profesionalizëm dhe fokusohet tek raportimi objektiv i lajmeve, duke shmangur qëndrimet editoriale në mbështetje të cilësdo forcë politike. Media të bojkotojë çdo mesazh të dhënë nga subjektet zgjedhore apo zyrtarët publikë që mund të përmbajë elementë të propagandës zgjedhore.

MBI KRIIK

Mbi organizatën

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) është një organizatë jo-fitimprurëse dhe jo-qeveritare, e themeluar në tetor të vitit 1997 nga një grup studentësh. Qendra e organizatës është në Tiranë, dhe aktiviteti i saj shtrihet në të gjithë vendin, duke operuar nëpërmjet përfaqësuesve lokalë dhe/ose organizatave partnere. KRIIK është regjistruar në dhjetor 1997, në formën e shoqatës me anëtarësi. Trupa më e lartë vendimmarrëse e organizatës është Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve, e cila zgjedh organet drejtuese dhe mbikëqyr punën e tyre, si dhe miraton dokumentet e rëndësishme statutores, strategjike dhe politike.

Vlerat themelore në të cilat bazohet aktiviteti i KRIIK janë angazhimi qytetar vullnetar; paanësia dhe pavarësia; integriteti; konsekuenca në përmbushjen e misionit me profesionalizëm dhe përkushtim; objektiviteti në vlerësimin e fakteve dhe argumenteve; respekti për diversitetin njerëzor dhe atë të opinioneve; transparenca në veprimtari dhe ruajtja e mjedisit.

Vizioni i KRIIK është ai i një shoqërie ku mbizotëron shteti ligjor; respektohen katërcipërisht dhe pa kompromis të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, liritë qytetare, politike dhe të ndërgjegjes të të gjithë individëve, pa asnjë dallim; ku mbizotëron sensi i komunitetit dhe qytetarët janë të angazhuar në hartimin e politikave publike në mënyrë domethënëse dhe sovrane dhe ku përfaqësuesit e zgjedhur e zyrtarët e tjerë publikë kanë si interes parësor mirëqenien e qytetarëve. KRIIK punon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjes demokratike; nxitjen e aktivizmit dhe angazhimit qytetar dhe nxitjen e llogaridhënies së institucioneve publike dhe politike.

Angazhimi në lidhje me integritetin zgjedhor

KRIIK është angazhuar në vëzhgimin e zgjedhjeve prej themelimit të vet, duke angazhuar aktivistë si vullnetarë në aksione vëzhgimi të zgjedhjeve të tjera organizatave. Prej vitit 2000, KRIIK ka qenë pjesë aksioneve të përbashkëta të vëzhgimit të disa grupeve të organizatave vendase.

Prej 2005, KRIIK ka qenë anëtar themelues e më pas edhe një nga organizatat drejtuese të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), grupimi më i madh i organizatave vendore që kanë vëzhguar zgjedhjet në Shqipëri. Në kuadër të apo në bashkëpunim me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, KRIIK ka vëzhguar të gjitha zgjedhjet e përgjithshme, parlamentare apo lokale, të zhvilluara në Shqipëri prej vitit 2005 deri në vitin 2017 si dhe shumicën e proceseve zgjedhore të pjesshme të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2019, KRIIK vëzhgoi Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të atij viti, në bashkëpunim me bashkëpunim me nëntë organizata lokale me eksperiencë në vëzhgimin e zgjedhjeve, të cilët angazhuan burimet e veta në ndihmë të aksionit të vëzhgimit, si dhe aktivistët e tyre si vëzhgues afatgjatë:

KRIIK, në bashkëpunim me Elections to Conduct Agency (ECA) kanë realizuar për herë të parë në Shqipëri numërimin paralel të votave në rang vendi, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009.

Si pjesë e Rrjetit European të Organizatave Vëzhguese të Zgjedhjeve, një rrjet organizatash lider në vëzhgimin e zgjedhjeve në Europën Juglindore dhe Qendrore, Europën Lindore, dhe Azinë Qendrore, KRIIK ka kontribuar prej vitit 2009 në forcimin e integriteti zgjedhor në disa vende të këtij rajoni, duke angazhuar aktivistë të vet si vëzhgues në misione ndërkombëtare vëzhgimi, në të gjitha nivelet e misioneve (Ekip Bazë, përfshi drejtues misioni; vëzhgues afatgjatë dhe vëzhgues afatshkurtër). KRIIK është pjesë e Sekretariatit të ENEMO-s, aktualisht në mandatin e dytë në këtë pozicion.

Përveç angazhimit në vëzhgimin e proceseve zgjedhore, KRIIK ka ndërmarrë një numër iniciativash që synojnë të forcojnë integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe ndjek në mënyrë të vazhdueshme (jo vetëm gjatë periudhave zgjedhore) çdo zhvillim politik apo institucional që ka potencialin të ndikojë në integritetin e zgjedhjeve.

AKRONIME

ADR	Partia Aleanca Demokracia e Re
AAK	Partia Aleanca Arbnore Kombëtare
ABDE	Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane
ABEOK	Aleanca Bashkimi, Emigracioni, Ora dhe Konservatorët
ADK	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë
ADS	Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
AK	Partia Aleanca Kuq e Zi
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMIE	Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European
AP	Avokati i Popullit
AP	Avokati i Popullit
BD	Partia Bindja Demokratike
BMM	Bordi i Monitorimit të Mediave
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
FRD	Partia Fryma e Re Demokratike
FRD	Partia Fryma e Re Demokratike
G99	Partia G99
GNV	Grupi i Numërimit të Votave
GNV	Grupi i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Veprave Penale
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Veprave Penale
KAS	Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Komisioneri	Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet
KONSAL	Partia Kombëtare Konservatore Albania
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZ	Kolegji Zgjedhor
KZ	Kolegji Zgjedhor
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LDE	Partia Për Liri Demokraci dhe Etike
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
LZHK	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar
MB	Ministria e Punëve të Brendshme
MEGA	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
NTH	Partia Nisma Thurje
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PAA	Partia Agrare Ambjentaliste
PAD	Partia Aleanca Demokratike
PASH	Partia Ardhmëria Shqiptare
PBD	Partia Bindja Demokratike
PBDNJ	Partia Bashkimi për të drejtat e Njeriut
PBDSh	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar
PBK	Partia Balli Kombëtar
PBK	Partia Balli Kombëtar
PBKD	Partia Balli Kombëtar Demokrat
PBLD	Partia Bashkimi Liberal Demokrat
PBLD	Partia Bashkimi Liberal Demokrat
PBPPSH	Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar
PD	Partia Demokratike
PD	Partia Demokratike
PD-AN	Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim
PDIP	Partia Demokrate per Integrim dhe Prosperitet
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PDIU	Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet
PDKSH	Partia Demokristiane e Shqipërisë
PDM	Partia e të Drejtave të Mohuara
PDRE	Partia Demokracia e Re Europiane
PDS	Partia Demokracia Sociale
PESH	Partia Emigracioni Shqiptar
PESH	Partia Emigracioni Shqiptar
PGJ	Partia e Gjellbër
PKD	Partia Kristian Demokrate
PKD	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë
PKKA	Partia Kombëtare Konservatore Albania
PKSH	Partia Komuniste e Shqipërisë
PLDSH	Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare
PLL	Partia Lëvizja e Legalitetit
PLN	Partia Lëvizja për Ndryshim
PLPSH	Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare
PLR	Partia Lëvizja e Re
PMDE	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigranteve
PMDPSH	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë
POSH	Partia Ora e Shqipërisë
POSH	Partia Ora e Shqipërisë

PPAK	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar
PPK	Partia e Pajtimit Kombëtar
PRDSH	Partia Republikane Shqiptare
PRDSH	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
PS	Partia Socialiste e Shqipërisë
PS	Partia Socialiste e Shqipërisë
PSD	Partia Socialdemokrate
PSD	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
PSM	Partia Socialiste e Moderuar
PSPSH	Partia Social Punëtore e Shqipërisë
PUK	Partia e Unitetit Kombëtar
QV	Qendër Votimi
QV	Qendër Votimi
QV	Qendër Votimi
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
Rregullatori	Komisioni Rregullator
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNV	Vend i Numërimit të Votave
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrë e Gjendjes Civile
ZGJC	Zyrë e Gjendjes Civile
ZRZ	Zyrë Rajonale Zgjedhore
ZRZ	Zyrë Rajonale Zgjedhore